

VENDIM
Nr. 00-2025-1007(82), datë 27.3.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Ilir Panda	kryesues;
Medi Bici	anëtar;
Sokol Binaj	anëtar;
Albana Boksi	anëtare;
Sandër Simoni	anëtar,

sot, më datë 27.3.2025, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale që i përket:

KËRKUES: Xhuljo Krasniqi, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufijve”, kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 298/2, 28.4, 333/a, 334/1 të Kodit Penal.

PALË E INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

OBJEKTI: Verifikimin e nevojave aktuale të sigurimit dhe zëvendësimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, me një masë më të butë sigurimi.

BAZA LIGJORE: Neni 246/6 i Kodit të Procedurës Penale.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Sandër Simoni, prokuroren pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Elida Kaçkini, e cila kërkoi *“Prishjen e vendimit nr. 235, datë 25.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.”*, mbrojtësit e zgjedhur të personit nën hetim Xhuljo Krasniqi, avokatët Artan Gjermani dhe Sokrat Gjermani, të cilët kërkuan: *“Prishjen e vendimit nr. 235, datë 25.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues”*, dhe bisedoi çështjen në tërësi, në përfundim,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim “Prokuroria e Posaçme”) ka regjistruar procedimin penal nr. 188, të vitit 2023, në kuadër të të cilit po hetohet lidhur me kalimin e shtetasve të Bangladeshit nga Shqipëria drejt kufijve të vendeve të Bashkimit Evropian nga një grup i strukturuar kriminal, i përbërë nga disa persona, veprimet e të cilëve nisin me aplikimet për t’i pajisur ata në Shqipëri me leje unike dhe me vizë “D” për punësim, me pritjen, strehimin e përkohshëm dhe transportimin e tyre deri në pikat kufitare nga ku ata kalonin ilegalisht për të mbërritur në destinacion final. Në këtë procedim, i hetuari Xhuljo Krasniqi dyshohet se në koordinim me bashkëpunëtorët e tjerë ka kryer veprimet e pritjes së shtetasve nga Bangladeshi, duke plotësuar dokumentacionin për “punësimin” e tyre në aktivitetin e tij si person fizik. Në kuadër të këtij procedimi penal, me vendimin nr. 37, datë 10.4.2024, të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal “arrest në burg”, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale të cituara më lart. Ky vendim është miratuar nga gjykata e apelit.

2. Më datë 11.10.2024, kërkuesi Xhuljo Krasniqi ka paraqitur kërkesë në gjykatë për verifikimin e nevojave të sigurimit dhe zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga arrest në burg në një masë më të lehtë. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (gjyqtari

i hetimit paraprak) ka vendosur shqyrtimin në seancë gjyqësore të informacionit me shkrim të Prokurorisë së Posaçme, në lidhje me gjendjen e procedimit penal nr. 188, të vitit 2023, hetimet e kryera pas momentit të caktimit të masës së sigurimit dhe nevojat e sigurimit. Seanca është zhvilluar në prani të kërkuesit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të posaçëm. Në këtë seancë Prokuroria e Posaçme ka paraqitur informacionin me shkrim të shoqëruar me kopje të akteve të fashikullit. Një kopje e këtyre akteve në seancën gjyqësore të datës 14.7.2024 i është vënë në dispozicion personit nën hetim Xhuljo Krasniqi dhe mbrojtjes. Kërkuesi/personi nën hetim Xhuljo Krasniqi ka kërkuar zëvendësimin e masës së sigurimit personal me një më të butë. Prokuroria e Posaçme ka kërkuar vazhdimin e masës së zbatimit të masës së sigurimit “arrest me burg”, për personin nën hetim/kërkuesin Xhuljo Krasniqi.

3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 574, datë 17.10.2024, ka vendosur:

“Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Xhuljo Krasniqi dhe mbrojtësit të tij, për zëvendësimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’, të caktuar me vendimin nr. 37, datë 10.4.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me masën sigurimit ‘garanci pasurore’, apo ‘arrest në shtëpi’, sipas neneve 236, 237 të KPP-së si të pabazuar në ligj dhe në prova.”

4. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, në mbështetje të vendimarrjes së saj ka dhënë këto arsye: Nga aktet e paraqitura në seancë gjyqësore, nuk rezultoi që ndonjë nga provat e marra dhe të shqyrtuara në momentin e caktimit të masës së sigurimit, të vlerësuara si të afta, në krijimin e dyshimit të arsyeshëm, për përfshirjen e tij në kryerjen e veprës penale, të jetë deklaruar e pavlefshme, e papërdorshme, e falsifikuar, apo të jetë vënë në dyshim ndonjë prej tyre. Hetimet në lidhje me këtë procedim penal vijnë prej disa muajsh dhe pas caktimit të masës së sigurimit personal edhe për të hetuarin Xhuljo Krasniqi. Rezulton se kryesisht ato kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe verifikimin e sendeve të gjetura në momentin e arrestimit të personave nën hetim, si edhe personave të tjerë për llogari të këtij procedimi penal, pyetjes së personave që kanë dijeni për rrethanat të çështjes, pritjes së përgjigjeve të të dhënave të ekspertimeve telefonike etj. Në kuadër të hetimit ka lindur e nevojshme administrimi i disa të dhënave nga kompanitë celulare, të dhëna të cilat vlerësohen të rëndësishme nga kjo gjykatë për të hedhur dritë në lidhje me informacionin mbi vendndodhjen, qelizat e thirrjeve hyrëse dhe dalëse dhe komunikimet që mund të jenë realizuar nga disa prej personave nën hetim. Organi i akuzës është në pritje të administrimit të disa dokumenteve dhe realizimit të disa këqyrjeve të cilat kanë lindur të nevojshme të kryhen në kuadër të dokumentacionit të mbledhur deri në këtë fazë të hetimit. Nga organi i akuzës, gjatë periudhës 2-mujore (dymujore) janë grumbulluar prova të reja në funksion të hetimit të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes penale.

4.1 Kërkesa e mbrojtësit të të hetuarit Xhuljo Krasniqi për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” dhënë ndaj tij, është haptazi e pambështetur në ligj e në prova. Nga aktet e disponuara në dosje, në ngarkim të të hetuarit/kërkues Xhuljo Krasniqi vijnë të ekzistojnë të njëjtat kushte e kritere që janë vlerësuar në momentin e caktimit të masës së sigurimit ndaj tij, vazhdon të ekzistojë dyshimi i mbështetur në prova për kryerjen e veprave penale që i atribuohet, vepra penale për të cilat nuk ekziston asnjë shkak padënueshmërie, apo i shuarjes të tyre. Mbrojtja nuk paraqiti asnjë provë/akt/të dhënë për të justifikuar pretendimin që masa e zbatuar nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit apo dënimit që mund të caktohet.

4.2 Nga veprimet hetimore të kryera nuk rezulton të kenë ndryshuar rrethanat e faktit apo kushtet dhe kriteret ligjore të vlerësuara nga Gjykata e Posaçme në momentin e caktimit të masës së sigurimit ndaj kërkuesit të hetuarit. Deri në këtë fazë të hetimit vazhdon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm se shtetasi Xhuljo Krasniqi ka kryer veprat penale të parashikuara përkatësisht nga nenet 298, paragrafi 2, 28 pika 4, 333/a, 334 pika 1, të KP-së. Nuk kanë ndryshuar asnjë nga kriteret dhe kushtet ligjore të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të KPP-së, për caktimin e masave të sigurimit personal. Vazhdon të ekzistojë edhe kushti i dytë i përgjithshëm, i parashikuar në nenin 228 të KPP-së. Veprat penale për të cilat dyshohet shtetasi Xhuljo Krasniqi, nuk rezultojnë të jenë shuar, për shkak të ndonjë

shfuqizimi dispozite, apo amnistie. Nuk konstatohet as ndonjë shkak padënueshmërie, për efekt të ligjit penal.

4.3 Nga momenti i caktimit të masës së sigurimit dhe deri në këtë fazë hetimi paraprak, vërtetohet se ndaj personit nën hetim Xhuljo Krasniqi vijon të ketë këtë dyshim, i cili në raport me ecurinë e gjendjes së procedimit, nuk është zbehur aspak. Ekzistojnë edhe kushtet e veçanta të parashikuara nga neni 228/3, si dhe kriteret e përcaktuar në nenin 229 të KPP-së, për vijimin e masës “arrest në burg”. Ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar, që i hetuari mund të vërë në rrezik marrjen, apo vërtetësinë e provave të tjera, pikërisht në drejtëm të zbardhjes së plotë të rrethanave të kryerjes së kësaj vepre penale. Mënyra e kryerjes së aktivitetit të kundërligjshëm, dyshimet e prokurorisë se ky është një aktivitet i shtrirë në kohë, i kryer në bashkëpunim, janë disa nga arsyet që mbështesin ekzistencën e një rreziku potencial për ndikimin të provat.

4.4 Në ndryshim nga sa pretendon mbrojtja, kjo gjykatë vlerëson se ekzistojnë edhe kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 229 e 230 të KPP-së. Masa e “arrestit me burg” vijon të jetë në përputhje me rëndësinë e faktit dhe shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret, fakti penal që i atribuohet kërkuesit nuk ka ndryshuar, fakt ky që përlligj përshtatshmërinë e masës së sigurimit me masën e dënimit që parashikohet për veprën penale konkrete që i atribuohet atij. Kjo gjykatë, vijon të mbajë në konsideratë: a) shkallën e nevojave të sigurimit në rastin konkret, e lidhur me rrezikshmërinë që paraqet i hetuari, që vijon të jetë i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve”, kryer në bashkëpunim në formë të grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerje e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, mundësinë për krijimin e pengesave në zbulimin e plotë të rrethanave, dhe të bashkëpunëtorëve në kryerjen e kësaj vepre penale (neni 229, pika “1”); rëndësinë e faktit të kryer dhe përshtatshmërinë e masës së sigurimit me masën e dënimit që parashikohet për veprën penale konkrete, që i atribuohet kërkuesit/të hetuarit Xhuljo Krasniqi (neni 229, pika (e) rrezikshmërinë e veçantë të veprës penale, e cila dyshohet të jetë në bashkëpunim të organizuar.

4.5 Asnjë nga pretendimet e parashtruara nga ana e mbrojtjes, në lidhje me gjendjen familjare, nuk janë të tilla që të justifikojnë mungesën e kushteve dhe kriterëve për caktimin e masës së arrestit në burg, apo qoftë edhe ndryshimin zbutjen e saj në rastin konkret. Nga ana e mbrojtjes nuk u paraqit asnjë provë për vërtetimin e rrethanave që dëshmojnë për zbutje të nevojave të sigurimit, apo që masa e zbatuar nuk i përgjigjet rëndësisë së faktit ose edhe dënimit që mund të caktohet. I hetuari Xhuljo Krasniqi vijon të jetë nën të njëjtën pozitë procedurale si në momentin e caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg”. Rrethanat e tjera hetimore, si informimi për të arrestuarin Xhuljo Krasniqi, në lidhje me gjendjen e procedimit, gjykata vjen në përfundimin se nuk është vendi për zëvendësim të masës së sigurimit të dhënë ndaj tij.

5. Kundër këtij vendimi **ka paraqitur ankimin i hetuari Xhuljo Krasniqi**, me anë të të cilit ka kërkuar ndryshimin e vendimit, duke zëvendësuar masën e sigurimit “arrest në burg” me një masë më të butë “arrest në shtëpi” ose “detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Në ankim, i hetuari, ndër të tjera, ka parashtruar këto shkaqe:

- Kushtet dhe rrethanat e sigurimit janë zbutur si pasojë e provave dhe akteve që ekzistojnë deri në këtë fazë të hetimit.

- Masa e sigurimit e zbatuar ndaj personit nën hetim Xhuljo Krasniqi nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit, duke errësuar fuqinë provuese të provave që provojnë dyshimin e arsyeshëm në caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”.

- Personi nën hetim Iglan Allçi i ka ofruar personit nën hetim Xhuljo Krasniqit punëtorë të huaj për nevojat e tij në bujqësi dhe në blegtori.

- Referuar deklarimeve dhe përgjimeve, errësohet më shumë fuqia provuese e provave që krijojnë dyshimin e arsyeshëm.

- Nga përmbajtja e përgjimeve nuk tregohet dhe vërtetohet se personi nën hetim Xhuljo Krasniqi ka kryer veprime të tilla që e implikojnë në veprimtari kriminale.

- Referuar akuzës është shtetasi Iglan Alliçi që ka kryer pagesat për leje unike për personat që kërkoheshin nga shtetasi Xhuljo Krasniqi.

- Vendimi objekt ankimi është i gabuar pasi gjykata shkruan se në mbështetje të pretendimeve, nuk u paraqit asnjë provë, ndërkohë prova janë deklarimet e shtetasit Gerald Musabelliu dhe të personit nën hetim Iglan Alliçi, që gjykata nuk i ka analizuar dhe marrë parasysh.

- Në vendim pasqyrohet një tjetër vepër penale ndaj Xhuljo Krasniqit, që tregon mosseriozitetin e gjykatës në shkrimin e argumenteve.

- Vendimi objekt ankimi është një vendim i marrë “copy paste”, duke mos respektuar parimet kushtetuese të një vendimi të arsyetuar.

- Vendimi i ankimit është në kundërshtim me KPP-në, parimet kushtetuese të arsyetimit të vendimit dhe praktikën e GJEDNJ-së.

- Ankimi referon në vendimin njëses nr. 1/2009.

6. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 235 (87-2024-345), datë 25.11.2024, ka vendosur:

“Miratimin e vendimit nr. 574, datë 17.10.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”

7. Gjykata e Posaçme e Apelit, në mbështetje të vendimmarrjes, ka dhënë këto arsye: Në të kundërt nga sa ankohet, ky kolegji vlerëson se në vendimin objekt ankimi, gjykata në mënyrë të qartë dhe pa kundërthënie u ka dhënë përgjigje pikave thelbësore të çështjes së paraqitur para saj një zgjidhje, në përputhje me objektin e saj. Sikurse rezulton nga vendimi i gjenezës së masës së sigurimit në fuqi ndaj të hetuarit Xhuljo Krasniqi, e tillë masë është caktuar, sepse ka pasur motive të arsyeshme të bazuara në prova se ai është autor i mundshëm i veprave penale për të cilat hetohet dhe lënia në liri apo pa masë sigurimi e tij mund të rrezikonte efektivitetin e procedimit objekt shqyrtimi dhe sigurinë e komunitetit jashtë tij, pasi ishin të pranishme tre rrethana sikurse janë rreziku se ai: i. mund të cenonte procesin e mbledhjes dhe vërtetësisë së provave; ii. mund të ikte për t’iu shmangur procedimit; dhe iii. mund të kryente vepra penale të të njëjtit lloj, apo më të rënda, të përcaktuara nga shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 3, të nenit 228, të KPP-së. Në kontrollin aktual të nevojave të sigurimit të të hetuarit Xhuljo Krasniqi, përkundërt procedimit të ngritur ndaj tij, ky kolegji i Apelit, njëlloj si gjykata e shkallës së parë çmon, se ato paraqiten të pandryshuara, apo të qëndrueshme, pasi aktualisht nuk kanë ndryshuar rrethanat për të cilat në gjenezë është konkluduar se ai duhet të shtrëngohej me një masë personale sigurimi, sikundër “arresti në burg”.

7.1 Në të kundërt nga sa ankohet, procedimi i ngritur ndaj të hetuarit Xhuljo Krasniqi, aktualisht vijon të jetë në fazën e hetimeve paraprake, nga deduktohet se rreziku i parashikuar nga neni 228/3 shkronja “a”, të KPP-së i njohur si rreziku i “helmimit të provave” është i lartë dhe po ashtu i njëjtë me momentin e gjenezës së masës së sigurimit ndaj tij. Ky rrezik, si në momentin fillestar dhe aktualisht vlerësohet i lidhur me fazën dinamike ku ndodhen hetimet e procedimit të ngritur ndaj shumë personave, me fakte penale komplekse, si dhe mundësinë reale të të hetuarit Xhuljo Krasniqi për të ndikuar në këtë proces të marrjes dhe vërtetësisë së provës, sidomos të atyre me dëshmitarë. Në të kundërt nga sa ankohet, i qëndrueshëm dhe aktual rezulton dhe rreziku i ikjes së të hetuarit Xhuljo Krasniqi për t’iu shmangur drejtësisë, nisur nga dëshira natyrale për të ruajtur lirinë, në kushtet kur vepra penale objekt dyshimi ndaj tij, sipas nenit 298/2 të KP-së, parashikon dënimin vetëm me burgim (nga tre deri në shtatë vjet), të cilave u shtohen pesë vjet të tjerë burgim sipas nenit 334/1 të KP-së, për shkak se vepra është kryer në bashkëpunim të veçantë, grup të strukturuar kriminal. Po dënim me burgim parashikon dhe neni 333/a/2 i KP-së (nga dy deri në pesë vjet). Ky arsyetim mbështetet dhe në qëndrimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku arsyetohet se vetë rreziku mund të lidhet e të rezultojë edhe nga vetë natyra e akuzave në ngarkim të të gjykuarit, nga rëndësia e faktit e sanksionit për veprën penale dhe lloji e shkalla e pasojave të ardhura prej saj.

7.2 Po e qëndrueshme dhe aktuale është frika, apo rreziku që i hetuari Xhuljo Krasniqi të kryejë krime të të njëjtit lloj, apo më të rënda, duke vënë në rrezik me lirinë e tij, sigurinë e komunitetit. Ky

vlerësim është një probabilitet i arsyeshëm nisur nga fakti se provat e procedimit penal të ngritur ndaj të hetuarit Xhuljo Krasniqi mbështesin dyshimin se ai ka vepruar jo si një autor i vetëm, por si pjesë e një grupi të strukturuar kriminal, anëtarë të identifikuar të të cilit janë ende në kërkim e kësajsoj aktivë në krime të mundshme me rrezik të lartë shoqëror. Nevojat e sigurimit të të hetuarit Krasniqi, apo nevoja e mbajtjes në kontroll paraprak të lirisë së tij mbetet e qëndrueshme sikurse në gjenezën e masës së sigurimit personal të caktuar ndaj tij. Lidhur me provat e mbledhura në vijim të hetimeve paraprake të procedimit penal të ngritur ndër të tjerë, ndaj të hetuarit Krasniqi rezulton se të dhënat e tyre që lidhen me të gjithë veprimtarinë e grupit kriminal, ku i hetuari është bërë pjesë, nuk tronditin dyshimin e arsyeshëm të ngritur ndaj tij se është autor i veprave penale të parashikuara nga nenet 298/2, 28/4, 334/1 dhe 333/a të KP-së.

7.3 Në të kundërt nga sa pretendohet nga mbrojtja e të hetuarit Xhuljo Krasniqi, deklaratimet e dhëna nga shtetasi Gerald Musabelliu, për një rast të takimit dhe diskutimit për punësimin e shtetasve nga Bangladeshi mes të hetuarve Iglan Alliqi dhe Xhuljo Krasniqi, nuk errësojnë apo sfumojnë të dhënat e provave të tjera të mbledhura nga hetimet e procedimit të ngritur ndaj tij, pasi me përputhjen e fakteve të njoftuara prej tyre, ato janë të afta për të mbajtur peshën e dyshimit të arsyeshëm të ngritur në gjenezën e masës objekt shqyrtimi. Që deklaratimet e shtetasit Gerald Musabelliu, apo deklaratimet e vetë të hetuarve Xhuljo Krasniqi dhe Iglan Alliqi, të jenë të afta të “tronditin” dyshimin e arsyeshëm të ngritur ndaj të hetuarit Krasniqi sikurse pretendohet, duhet jo vetëm që të kenë përputhje, apo harmoni mes tyre, por të hedhin poshtë të dhënat e provave të shqyrtuara në gjenezën e masës dhe ato të mbledhura në vijim të hetimit.

7.4 Sikurse motivet fillestare dhe motivet aktuale janë të rëndësishme dhe të mjaftueshme për të vijuar paraburgimin ndaj të hetuarit Xhuljo Krasniqi, liria e të cilit rrezikon si ecurinë dhe efektivitetin e procedimit objekt shqyrtimi, ashtu dhe sigurinë e komunitetit jashtë tij. Prej prokurorëve është vepruar me diligjencë të posaçme, duke u reflektuar veprimtaria, si në aspektin numerik të provave të mbledhura, ashtu dhe në cilësinë e tyre. Në kushtet kur nevojat e sigurimit ndaj të hetuarit Xhuljo Krasniqi mbeten të qëndrueshme dhe po ashtu nga prokurorët e posaçëm është treguar kujdesi i duhur që hetimet të zhvillohen me efektivitet dhe në kohën e arsyeshme, masa e arrestit ndaj tij në të kundërt nga sa ankohet, vijon të jetë e justifikuar ligjërisht dhe nuk cenon padrejtësisht të drejtat e tij njerëzore, sepse motivohet nga një interes i lartë publik real që justifikon vazhdimin e zbatimit të saj.

8. Kundër këtij vendimi **ka paraqitur rekurs personi nën hetim Xhuljo Krasniqi**, me anë të të cilit ka kërkuar prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim. Në rekurs, kërkuesi Xhuljano Krasniqi, ndër të tjera, ka parashtruar këto shkaqe:

- Rekursi ka rëndësi të pranohet bazuar në nenin 432/1, shkronja “b”, të KPP-së, sepse gjykimi në apel është bërë pa praninë e prokurorit;

- Ligjvënësi i ka përcaktuar me detaje rastet kur nuk është e nevojshme pjesëmarrja e palëve në gjykim;

- Sipas procedurës së kërkuar nga neni 246, pika 6, të KPP-së, prokurori jo vetëm duhet të jetë prezent në gjykim, por ka një rol aktiv në paraqitjen e informacionit, sipas afatit 2-mujor me diligjencë në zbatim të nenit 246 të KPP-së dhe vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 8.1.2009;

- Gjykata ka zhvilluar procedurën e parashikuar sipas nenit 246, pika 6, të KPP-së dhe ka dhënë vendim pa praninë e prokurorit. Ky veprim është rrezik me rëndësi për njësimin e praktikës ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;

- Mosrespektimi i ligjit procedural shfaqet haptazi edhe në mosarsyetimin dhe lënien pa përgjigje të pretendimit, në shkelje të nenit 245, pika “ç”, të KPP-së, si më poshtë:

- Në faqen 73 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë arsyetohet se nga aktet e parashtruara rezulton se gjatë afatit 2-mujor nga akuza janë kryer një sërë veprimesh hetimore duke treguar “diligjencën e duhur”. Gjykata parashtron se akuza është në pritje të administrimit të disa të dhënave nga kompanitë celulare, si qeliza të thirrjeve etj.;

- Ndërkohë, në faqen 76 është po kjo gjykatë e cila i tërheq vëmendjen prokurorisë që t'i mundësojë mbrojtjes aktet procedurale të ekspertimit teknik telefonik, të cilat vetë kjo gjykatë i konsideron në vendim si veprime procedurale të cilat rrëzojnë kërkesën e personit nën hetim Xhuljo Krasniqi;

- Pra qartazi, gjykata merr një vendim të pabazuar në prova dhe alogjik. Ky veprim përbën rrezik me rëndësi për njësimin e praktikës ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas pikës “a”, të nenit 432, të KPP-së;

- Vendimi objekt rekursi është në kundërshtim me KPP-në, parimet kushtetuese të arsytimit të vendimit, praktikën e GJEDNJ-së, vendimin njësuës nr. 1/2009, për shkak se akuza nuk e ka kryer dilijencën e duhur të kërkuar si nga neni 246 i KPP-së, por edhe nga praktika unifikuere e Gjykatës së lartë.

II. Nevoja për njësim të praktikës gjyqësore dhe qëndrimet e palëve

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim “Kolegji”), ka marrë në shqyrtim këtë çështje në dhomë këshillimi, ku konstatoi se rekursi është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji dhe brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të KPP-së. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (në vijim “Prokuroria e Posaçme”) është njoftuar për rekursin. Në këto kushte, rekursi plotëson kushtet formale të parashikuara nga neni 435/1 i KPP-së. Gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, Kolegji vlerësoi se në rekursin e paraqitur nga i gjykuari, ngrihen çështje ligjore me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, në vështrim të kërkesave të nenit 432, pika 1, shkronja “a”, të KPP-së, dhe duke konstatuar se jemi në rastet e parashikuara nga neni 437/1 shkronja “a”, të KPP-së, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

10. Neni 141/1 i Kushtetutës parashikon se Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. Edhe ligji procedural, në rastin konkret KPP-ja, në nenin 14/a parashikon, se: *“Gjykata e Lartë gjykon në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Gjykata e Lartë gjykon njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në kolegje me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore në kolegje të bashkuara.”*. Gjithashtu, në nenin 437/1, shkronja “a”, parashikohet, se: *“1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se: a) çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës, për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.”*. Njësimi dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore është funksioni kryesor kushtetues i Gjykatës së Lartë.

11. Gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore Kolegji konstatoi se ka qëndrime të ndryshme të gjykatave në zbatimin e ligjit procedural penal, lidhur me pjesëmarrjen e palëve, konkretisht organit të prokurorisë, gjatë shqyrtimit periodik të nevojave të sigurimit personal, konkretisht nenin 246/6 të KPP-së. Konstatohet se gjykatat e faktit kanë mungesë uniformiteti në lidhje me zhvillimin e seancës me praninë e prokurorit, në procesin që zhvillohet për shqyrtimin e informacionit periodik 2-mujor dhe verifikimin e nevojave të sigurimit, në fazën e hetimeve paraprake. Konstatohet se në shumicën e rasteve, seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e prokurorisë, të arrestuarit dhe mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar kryesisht. Megjithatë, dhe në raste të tjera konstatohen se, sikurse edhe ky objekt shqyrtimi, në të cilën seanca në gjykatën e shkallës së parë është zhvilluar me pjesëmarrjen e prokurorit, të arrestuarit dhe mbrojtësit, ndërsa seanca në gjykatën e apelit është zhvilluar pa praninë e prokurorit.

12. Duke pasur parasysh mënyrën e procedimit nga gjykatat e faktit në drejtim të palëve pjesëmarrëse në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP-së, si dhe nevojën për të garantuar qëndrueshmëri në gjykatat më të ulëta lidhur me zbatimin e këtij parashikimi ligjor, Kolegji evidentoi nevojën për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Nëpërmjet njësimit dhe zhvillimit të praktikës gjyqësore, Kolegji ka për qëllim njëtrajtësimin e praktikës gjyqësore në mënyrën e zbatimit të ligjit, me qëllim që të vendoset i njëjti standard për mënyrën e procedimit dhe palët pjesëmarrëse në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP-së. Për këtë arsye, në referim të neneve 14/a, 432/1, shkronja “a”, dhe 437/1, shkronja “a”, të KPP-së, Kolegji vlerësoi se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore (me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë), me qëllim njësimin dhe zhvillimin e praktikës

gjyqësore në lidhje me pjesëmarrjen e prokurorisë në shqyrtimin e nevojave të sigurimit sipas nenit 246/6 të KPP-së, si dhe pasojat që sjell zhvillimi i seancës pa pjesëmarrjen e saj. Në këtë kontekst, Kolegji vlerësoi këtë çështje interpretative të zbatimit të ligjit procedural, në funksion të përmbushjes së garancive procedurale për personin nën hetim e në zbatim të masës së sigurimit, duke konsideruar se dëgjimi i palëve është një parim thelbësor për të garantuar një proces të drejtë dhe kontradiktor, ndërkohë që gjykimi efektiv dhe i shpejtë e këtyre kërkesave si mundësi e kontrollit në kohë të zbatimit të masës së sigurimit është element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor. Gjykata e Lartë, nëpërmjet ushtrimit të funksionit kontrollues të karakterit ligjor dhe nomofilatik, ka për detyrë të sigurojë një raport të ngushtë midis uniformitetit dhe konsistencës së praktikës gjyqësore dhe së drejtës së individit për një gjykim të drejtë, duke evidentuar nëse ka praktika të ndryshme, duke parandaluar perceptimin e gabuar të subjekteve për cenim të garancive procedurale, në rast të zbatimit të ndryshëm të ligjit procedural dhe duke siguruar uniformitetin e tyre. Kjo, në kushtet kur dispozita ligjore procedurale është ndryshuar me ndryshimet e vitit 2017 në KPP.¹ Në këtë këndvështrim merr rëndësi pozicioni dhe roli i Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji, e cila sipas nenit 141 të Kushtetutës (*ndryshuar me ligjin nr. 76/2016*), ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta.

13. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se siguria juridike që duhet të përcjellë rendi juridik lidhur me aksesueshmërinë dhe parashikueshmërinë normative duhet të jenë standard edhe për praktikën gjyqësore njësuere². Ajo ka pranuar se kundërshtitë e jurisprudencës janë të natyrshme dhe të qenësishme në të gjitha sistemet juridike, qoftë në gjykata të së njëjtës shkallë, qoftë në shkallë të ndryshme, apo qoftë edhe në autoritetin suprem më të lartë gjyqësor, duke konkluduar se kjo situatë nuk mund të jetë *apriori* në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, GJEDNJ-ja konkludon se ajo që përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në drejtim të ushtrimit të funksionit nomofilatik të autoritetit më të lartë gjyqësor në një vend janë disa rrethana: *së pari*, nëse në jurisprudencën e gjykatave ekzistojnë qëndrime krejt të ndryshme dhe të vazhdueshme mbi të njëjtën çështje juridike; *së dyti*, nëse e drejta e brendshme parashikon mekanizma ligjorë dhe procedurale që synojnë efektivisht eliminimin e mungesës së koherencës në jurisprudencë; *së treti*, nëse këta mekanizma janë zbatuar nga autoriteti më i lartë gjyqësor dhe kush ka qenë efekti i prodhuar në praktikën gjyqësore. GJEDNJ-ja ka theksuar se juridiksioni gjyqësor suprem në çdo shtet duhet të tregojë vigjilencë në shquarjen dhe eliminimin e çdo mungese koherence në jurisprudencën e gjykatave³.

14. Për sa më sipër, në referim të nenit 438 të KPP-së, Kolegji ka disponuar me vendim të ndërmjetëm se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore (me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë), me qëllim njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen:

“1. A është e detyruar pjesëmarrja e prokurorit në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të Kodit të Procedurës Penale, në zbatim të masës së sigurimit personal të caktuar ndaj personit nën hetim?”

15. Në seancë gjyqësore të procedurës për njësim, Prokuroria e Posaçme, në lidhje me çështjen e shtruar për njësim mbajti këtë qëndrim (parashtruar më poshtë në mënyrë të përmbledhur):

- Në tërësinë e dispozitave të KPP-së, procesi gjyqësor në gjykimin e çështjeve penale, qoftë të kërkesave penale, qoftë dhe të çështjeve të themelit karakterizohet nga procesi kontradiktor i saj, çka nënkupton që procesi gjyqësor zhvillohet në praninë e detyrueshme të palëve, me përjashtim të rastit kur vetë ligjvënësi nisur nga natyra e çështjes, apo thelbit që kërkohet në gjykatë, mund të ketë përjashtime për shqyrtimin e tyre në dhomë këshillimi, ose pa praninë e palëve. Këto parime presupozojnë që secilës palë duhet t'i ofrohen mundësi të arsyeshme, për të paraqitur pretendimet për

¹ Pika 6 e nenit 246 të KPP-së, e ndryshuar, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale të RSH-së”.

² GJEDNJ-ja, vendimi mbi çështjen “Lupaș and Others v. Romania”, ap.nos. 1434/02, 35370/02 dhe 1385/03, paragrafi 67, ECHR 2006-XV.

³ GJEDNJ-ja, vendimi mbi çështjen “Mariyka Popova dhe Asen Popov kundër Bullgarisë”, kërkesa nr. 11260/10, seksion 5 i GJEDNJ-së, vendim nr. 11.04.2019, paragrafi 40.

çështjen, në kushte të tilla që të mos e vënë në disavantazh me palën tjetër. Synim kryesor i këtyre parimeve është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, çka ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata me objektivitet e paanësi (vendimet e Gjykatës Kushtetuese).

- Referuar përcaktimit të nenit 427/a të KPP-së, rastet e gjykimit në dhomë këshillimi, mbi bazë aktesh duhet të jenë të parashikuara në këtë Kod. Këto raste i gjejmë të përcaktuara në dispozita të veçanta të KPP-së; siç janë rastet e shqyrtimit të ankimit mbi vendimet e gjykatës që pranon përgjimin (neni 222/a i KPP-së), ankimi mbi zgjatjen e afateve të hetimit (neni 325 i KPP-së), gjykime të cilat për nga natyra e tyre mund të gjykohen vetëm mbi bazë të akteve dhe ose dokumenteve. Ndërsa në rastet e gjykimeve pa praninë e palëve, përmendim gjykimet e kërkesave mbi shuarjet e masave të sigurimit (neni 261/3 i KPP-së).

- Në kushtet kur mungon rregulli i shqyrtimit të kërkesave specifike, normalisht zbatohet parimi i përgjithshëm ai i garantimit të procesit kontradiktor në seancë, duke u respektuar normat procedurale, që caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykimit të veprave penale duke qenë këto rregulla të detyrueshme për subjektet e procedimit penal (neni 2 i KPP-së).

- Neni 249 i KPP-së nuk parashikon rregulla të veçanta përjashtuese mbi zhvillimin e seancës gjyqësore dhe në këtë këndvështrim për rastet e shqyrtimit të informacioneve mbi zbatimin e masës së sigurimit sipas neni 246/6 të KPP-së nuk parashikohen rregulla të veçanta përjashtuese.

- Përkundrazi, në këtë nen parashikohet detyrimi i gjykatës që të vendosë pasi të dëgjojë palët. Ndërsa neni 426, “pika” 5, i KPP-së parashikon detyrimin e gjykatës që në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë, dhe dëgjimi i palëve sipas neni 246/6 të KPP-së është i detyrueshëm për t’u zbatuar.

- Në nenin 128/a të KPP-së parashikohen rastet e pavlefshmërisë absolute. Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me: b) të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, ku njëri prej tyre lidhet me të drejtën e prokurorit.

- Nevoja e qenies së prokurorit në seancë lidhet me dëgjimin nga ana e gjykatës të qëndrimit të prokurorit ndaj shkaqeve të ankimit të personit nën hetim dhe mbrojtësit të tij mbi shkaqet e ankimit dhe mbi të drejtën që prokurori ka në ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjes në procedim. Kjo mënyrë e të vepruarit, gjithashtu, nuk e detyron gjykatën që të marrë rol aktiv në gjetjen e fakteve, të cilat lindin gjatë debatit gjyqësor.

- Pjesëmarrja e prokurorit është e detyrueshme në të dyja shkallët e gjykimit në gjykimet e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas neni 246/6 të KPP-së, në zbatim të masës së sigurimit personal të caktuar ndaj personit nën hetim.

16. Mbrojtësi i zgjedhur nga personi nën hetim në lidhje me çështjen e shtruar për njësim, mbajti këtë qëndrim:

- Sipas KPP-së së Republikës së Shqipërisë, vendimi i cili merret pa praninë e palëve është ai i parashikuar nga neni 261, pika 3, i KPP; ai i parashikuar nga neni 406/b i KPP-së; dhe ai i parashikuar nga neni 453 i KPP-së.

- Ligjvënësi i ka përcaktuar me detaje rastet kur nuk është e nevojshme pjesëmarrja e palëve në gjykim.

- Në rastin tonë, sipas procedurës së kërkuar nga neni 246, pika 6, i KPP-së, prokurori jo vetëm duhet të jetë prezent në gjykim por ka një rol aktiv në paraqitjen e informacionit sipas afatit 2-mujor me dilijencë në zbatim të neni 246 të KPP-së dhe vendimit të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 8.1.2009.

- Pjesëmarrja e prokurorit është e detyrueshme në të dyja shkallët e gjykimit, në gjykimet e verifikimit të nevojave të sigurimit sipas neni 246/6 të KPP-së, në zbatim të masës së sigurimit personal të caktuar ndaj personit nën hetim.

17. Për shkak të interesit që paraqet njësimi i praktikës gjyqësore, në këtë gjykim, Kolegji bazuar në nenin 438/7 të KPP-së, vlerësoi të kërkojë mendimin me shkrim nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila

çmohet se ka njohuri të posaçme për çështjen ligjore të shtruar për njësim. Në seancë gjyqësore, Prokuroria e Përgjithshme, në lidhje me çështjen e shtruar për njësim dha këtë mendim (parashtruar më poshtë në mënyrë të përmbledhur):

- Në përgjigje të pyetjes së shtruar nga Gjykata e Lartë për njësimin e praktikës gjyqësore, referuar pikës 6 të nenit 246 të KPP-së, mendojmë se pjesëmarrja e prokurorit në seancën gjyqësore për verifikimin e nevojave të sigurimit personal është detyrim procedural dhe jo fakultativ. Mënyra se si është ndërtuar kjo dispozitë dhe parimet që KPP-ja ka adaptuar nuk i lë hapësirë gjykatës që ajo të vlerësojë dhe të zgjedhë vetë mënyrën e zhvillimit të gjykimit me praninë e palëve, apo pa praninë e tyre.

- Sipas nenit 246/6, ligjvënësi i ka dhënë prokurorit një rol aktiv dhe specifik, duke e detyruar atë të paraqesë çdo dy muaj një informacion të detajuar mbi gjendjen e procedimit dhe nevojat e sigurimit. Informacioni duhet të jetë shoqëruar me akte konkrete të hetimit. Gjykata, para se të marrë vendimin për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit, ka detyrimin procedural që të dëgjojë palët, përfshirë në mënyrë të domosdoshme prokurorin, i cili është palë thelbësore në procesin penal dhe përgjegjës për administrimin e akteve të hetimit.

- Dispozita përcakton qartë rolin aktiv të prokurorit në këtë proces. Rëndësia e këtij roli qëndron në detyrimin e prokurorit për të prezantuar informacione thelbësore që ndikojnë drejtpërdrejt në vendimmarrjen e gjykatës, lidhur me masën e sigurimit, çka përfshin pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, të dhëna që prokurori është përgjegjës t'i sjellë në mënyrë aktive para gjykatës.

- Kjo dispozitë parashikon, se gjykata, “pasi dëgjon palët”, vendos për vazhdimin, zëvendësimin apo revokimin e masës së sigurimit. Togfjalëshi “dëgjon palët” tregon vullnetin e ligjvënësit për ta kushtëzuar këtë procedurë me pjesëmarrjen dhe dëgjimin e prokurorit, si palë e domosdoshme në proces. Në rast se prokurori nuk merr pjesë dhe nuk dëgjohej, ky parim ligjor procedural nuk është plotësuar, duke cenuar kështu parimin e kontradiktoritetit të përcaktuar në mënyrë të detajuar edhe nga nenet 248 dhe 249 të KPP-së.

- Në mbështetje të këtij konkluzioni vijnë dhe parashikimet e bëra në nenet 248 dhe 249 të KPP-së.

- Neni 248 përcakton procedurën fillestare të marrjes në pyetje të personit të arrestuar, për verifikimin e kushteve dhe të kriterëve të caktimit të masës së sigurimit. Në pikën 3 të këtij neni parashikohet në mënyrë të qartë, se: “Në pyetjen e të arrestuarit marrin pjesë prokurori dhe mbrojtësi...”.

- Sipas këtij parashikimi, pjesëmarrja e prokurorit është e detyrueshme që në fazën e parë të marrjes në pyetje nga gjykata të të arrestuarit për verifikimin fillestar të masës së sigurimit. Ky parim procedural i pjesëmarrjes së detyrueshme dhe aktive të prokurorit, për analogji logjike dhe juridike, mbetet po aq i rëndësishëm dhe në verifikimet e mëvonshme periodike sipas nenit 246, pika 6, të cilat kanë për qëllim përsëri të shqyrtojnë kriteret e nevojave të sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të KPP-së.

- Kjo dispozitë ligjore konfirmon qartë vullnetin e ligjvënësit për ta konsideruar prokurorin palë të domosdoshme në çdo procedurë që lidhet me masat e sigurimit personal.

- Ndërsa neni 249 i KPP-së, i cili përcakton procedurën e ankimit kundër masave të sigurimit, parashikon në mënyrë të qartë në pikën 4, se data e seancës u njoftohet detyrimisht prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Ky detyrim i bën palët të jenë pjesëmarrëse aktive dhe të domosdoshme në gjykim.

- Fakti që gjykata e apelit vendos për ankimin, duke shqyrtuar provat dhe argumentet e paraqitura nga palët, tregon se roli i prokurorit nuk mund të jetë formal apo fakultativ, por përkundrazi, është detyrim procedural që ai të jetë i pranishëm, për të garantuar një vendimmarrje objektive dhe të drejtë nga gjykata.

- Duke vijuar më tej, neni 249 i KPP-së, në pikën 6 parashikon, se: *“Gjykata vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit, edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato*

që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit”. Pra gjykata e apelit mund të vendosë edhe për arsye të ndryshme nga ato që palët kanë parashtruar. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, evidentohet rëndësia që ka pjesëmarrja e prokurorit në gjykim, sepse vendimi mund të bazohet mbi argumente shtesë ose argumente të tjera nga ato që palët kanë dhënë fillimisht. Në këtë kontekst, mungesa e prokurorit shkakton boshllëk procedural dhe rrit rrezikun e një vendimmarrjeje të paplotë apo të padrejtë, për shkak të mungesës së kontributit të tij aktiv.

- Referuar përmbajtjes së dispozitave ligjore të analizuara më sipër, nenet 246/6, 248 dhe 249 të KPP-së, rezulton se pjesëmarrja e prokurorit në seancën gjyqësore të verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP-së, është e detyrueshme dhe jo opsionale.

- Mosrespektimi i këtij detyrimi procedural cenon rëndë parimin e kontradiktoritetit dhe objektivitetin e vendimmarrjes gjyqësore. Mungesa e prokurorit privon gjykatën nga informacioni thelbësor për hetimin, që është detyrim ekskluziv i prokurorisë sipas nenit 246/6. Duke marrë në konsideratë analogjinë dhe konsistencën e dispozitave (248 dhe 249), është e qartë se ligjvënësi e ka trajtuar prokurorin në mënyrë konstante, si palë aktive dhe esenciale në këtë proces.

- Në të kundërt, vendimmarrja e gjykatave pa pjesëmarrjen e prokurorit dhe mbrojtësit të të interesuarit, cenon procesin e rregullt ligjor, duke cenuar mbrojtjen e interesit publik në një proces penal, për mbrojtjen e të cilit, kushtetuta dhe ligjet kanë ngarkuar prokurorin si subjekti përgjegjës që garanton ndjekjen penale në të gjitha fazat e hetimit dhe gjykimit. Rrjedhimisht, zhvillimi i seancës pa praninë dhe pjesëmarrjen aktive të prokurorit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP-së, përbën shkelje të rëndë procedurale, duke shkaktuar pavlefshmërinë absolute të vendimit në kuptim të nenit 432 pika 1, shkronja “b”, të KPP-së.

- Përfundimisht, në lidhje me pyetjen e shtruar nga ana juaj, mbajmë qëndrimin, se: *“Në gjykimin e zhvilluar për verifikimin e nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP-së, në zbatim të masës së sigurimit personal të caktuar ndaj personit nën hetim, pjesëmarrja e prokurorit është e detyrueshme. Zhvillimi i këtij lloji gjykimi pa pjesëmarrjen e prokurorit e bën atë absolutisht të pavlefshëm.”*

III. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë:

18. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim “Kolegji”), sjell në vëmendje se, ndërsa në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në vijim “KEDNJ”) sanksionohen parime të përgjithshme për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor, garancitë për personin që kufizohet në të drejtën e lirisë personale parashikohen më hollësisht në nenin 5 të saj. Sipas kësaj dispozite, kufizimi i lirisë legjitimohet vetëm në rrugë përjashtimore dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj. Një nga rastet është ai i parashikuar në pikën 1, shkronja “c”: *“... kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale, ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj”*. Konventa, në pikën 3 dhe 4 ofron disa garanci të tjera thelbësore lidhur me kufizimin e lirisë, pikërisht ato të kontrollit efektiv gjyqësor të ushtruar nga gjykata të pavarura, brenda afateve të shkurtra dhe të arsyeshme, duke parashikuar, se: *“3. Çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1 / c të këtij neni duhet të çohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në gjykim e sipër. Lirimi mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t’u paraqitur në procesin gjyqësor. 4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.”*

19. Dispozitat e neneve 27, 28 dhe 30 të Kushtetutës përkojnë me qëllimin dhe interpretimin e nenit 5 të Konventës, e cila së bashku me nenet 2, 3 dhe 4 të saj janë themeli i të drejtave themelore të njeriut për sa i përket mbrojtjes fizike të individit, posaçërisht edhe të lirisë së personit. Duke interpretuar këto dispozita, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se qëllimi kryesor i tyre është të parandalojnë deprivimin arbitrar ose të pajustificuar të lirisë” (*Castravet kundër Moldavisë, GJEDNJ 2007*). Pikat 1 dhe 2 të nenit 28 të Kushtetutës dhe pika 3 e nenit 5 të Konventës sanksionojnë të drejtën e njeriut që, nëse parashtron kërkesa e pretendime të lidhura me

heqjen apo ndryshimin e masës së sigurimit personal, veçanërisht asaj të arrestit: “ato dubet t’i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor nga gjykata”.

20. Neni 5/4 është *habeas corpus* i Konventës. Ai i jep çdo të ndaluar të drejtën për të kërkuar që ndalimi i tij të kontrollohet menjëherë nga gjyqtari (Mooren *k. Gjermanisë*, pg. 106; Rakevich *k. Rusisë*, pg. 43). Nuk përjashtohet që respektimi i kërkesave të nenit 5/4 të mund të garantohet nga një sistem rishqyrtimi periodik automatik i ligjshmërisë së një ndalimi nga ana e gjyqtarit. Sidoqoftë, nëse vendoset një sistem kontrolli automatik, vendimet që shprehen rreth ligjshmërisë së ndalimit duhet të vijojnë në “intervale të arsyeshme” (Abdulkhanov *k. Rusisë*, pg. 209 e 212-214). Neni 5/4 i jep mundësi çdo të ndaluar që t’i kërkojë një gjykatë kompetente të marrë vendim “brenda një afati të shkurtër” rreth pikës nëse heqja e lirisë ndaj tij është bërë apo jo “e paligjshme” në dritën e elementeve të reja të shfaqura pas vendimit fillestar që e urdhëron këtë masë (Abdulkhanov *k. Rusisë*, pg. 208; Azimov *k. Rusisë*, pg. 151-152). Neni 5/4 nuk i detyron shtetet kontraktuese që të vendosin një shkallë të dyfishtë juridiksioni për shqyrtimin e ligjshmërisë së ndalimit. Megjithatë, një shtet që pajiset me një sistem të tillë duhet që në parim t’u japë të ndaluarve edhe në apel të njëjtat garanci, ashtu si në shkallë të parë (Kučera *k. Sllovakisë*, pg. 107; Navarra *k. Francës*, pg. 28; Toth *k. Austrisë*, pg. 84).

21. Ndonëse procedura që lidhet me nenin 5/4 nuk duhet të shoqërohet gjithmonë me garanci të njëjta si ato që porosit neni 6 për mosmarrëveshjet civile ose penale, ajo duhet të ketë një karakter gjyqësor dhe t’i ofrojë individit të interesuar garanci të përshtatura sipas natyrës së heqjes së lirisë për të cilën ai ankohet (*A. me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, pg. 203; Idalov *k. Rusisë*, pg. 161). Për çdo person ndalimi i të cilit i takon fushës së zbatimit të nenit 5/1, pika “c”, kërkohej patjetër një seancë (Nikolova *k. Bullgarisë*, pg. 58). Procedura duhet të jetë me ballafaqim dhe ta garantojë në të gjitha rastet “barazinë e armëve” midis palëve (Reinprecht *k. Austrisë*, pg. 31; *A. me të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, pg. 204). Parimet e ballafaqimit dhe të barazisë së armëve duhet të respektohen që të dyja edhe në apel (*Çatal k. Turqisë*, pg. 33-34 dhe çështjet që citohen aty).

22. Nisur nga procedura e ndjekur në rastin konkret (por jo vetëm), ku shqyrtimi i ankimit në apel ndaj vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë për vijimin e qëndrimit në fuqi të masës së sigurimit “arrest në burg”, sipas neneve 246/6 dhe 249 të KPP-së është bërë pa praninë e organit të akuzës, si dhe detyrimet dhe standardet e përcaktuar në KEDNJ dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, Kolegji shtroi për njësim çështjen: “A është e detyrues pjesëmarrja e prokurorit në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP-së, në zbatim të masës së sigurimit personal të caktuar ndaj personit nën hetim?”

23. Neni 246/6 i KPP-së është ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017. Përpara ndryshimit, pika 6 e nenit 246 të KPP-së, kishte këtë formulim: “6. Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, gjykata që ka dhënë vendimin duhet të informohet nga prokurori për të arrestuarin. Informacioni jepet me shkrim dhe përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, për pyetjen e të pandehurit dhe të personave të tjerë, për përsëkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur është rasti, gjykata mund të revokojë ose të zëvendësojë masën e sigurimit.” Kjo dispozitë para ndryshimeve ka shkaktuar interpretime të gabuara në praktikën gjyqësore dhe për këtë shkak kanë ndërhyrë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat, me vendimin nr. 1, datë 8.1.2009, kanë unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me kuptimin e drejtë të këtij parashikimi ligjor, detyrat e subjekteve të procedurës penale gjatë shqyrtimit periodik të masës së sigurimit, si dhe natyrën e këtij gjykimi.

24. Kolegjet e Bashkuara në këtë vendim njësuës kanë përcaktuar, se: “Prandaj, nisur nga këto përfundime, duke pasur parasysh se veprimi i parimit të kontrollit gjyqësor mbi masën e arrestit mishërohet me të tjerave edhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e nenit 246 të KPP-së, gjykata kompetente duhet të shqyrtojë me shpejtësi çështjen në seancë gjyqësore, duke dëgjuar prokurorin dhe pretendimet përkatëse të individit ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit ose mbrojtësin e tij. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, mbështetur në parimet e normat kushtetuese dhe ndërkombëtare të detyrueshme si më sipër, si dhe kriteret ligjore të parashikuara në KPP, gjykata duhet të vendosë nëse kufizimi i lirisë për të arrestuarin është ose jo e justifikuar ligjërisht.”

25. Lidhur me detyrat e subjekteve procedurale gjatë gjykimit sipas nenit 246/6 të KPP-së, Kolegjet e Bashkuara unifikojnë praktikën gjyqësore, se: *“Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës, gjykata urdhëron prokurorin të riparojë shkëlqen e ligës, duke depozituar menjëherë informacionin dhe të dhënat mbi gjendjen e procedimit, të cilat i nënshtrohet hetimit gjyqësor dhe debatit mes palëve. Në këtë kuadër, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin tjetër unifikues, se, edhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e nenit 246 të KPP-së, sikurse në rastet e tjera kur paraqitet kërkesë nga vetë i arrestuari, në interpretim e zbatim të drejtë të pikës 2 të nenit 28 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të Konventës, gjykata e shqyrton çështjen në seancë gjyqësore dhe duhet të vendosë me shpejtësi, për vijimin, revokimin, ose zëvendësimin e masës së sigurimit.”* Sipas Kolegjeve të Bashkuara, në vendimin e sipërcituar, në një gjykim me objekt rivlerësimin e kësaj mase, gjykata duhet të çmojë e të vendosë edhe në varësi të vërtetimit ose jo të motiveve të tjera të parashtruara nga organi i akuzës për justifikimin e vazhdimit të kufizimit të lirisë së individit.

26. Kolegjet e Bashkuara, më tej unifikojnë praktikën gjyqësore, se: *“Organi i prokurorisë ka barrën e provës për të vërtetuar përpara gjykatës se ende ka bazë të justifikuar për vijimin e zbatimit të masës së arrestit. Objekti i informacionit të detyrueshëm nga prokurori, parashkrimi i kërkesave të palëve për revokim a zëvendësim të masës së arrestit, si dhe objekti i gjykimit mund të shtrihen edhe përtej ekzistencës ose jo të motiveve fillestare që kanë justifikuar caktimin e masës së arrestit në burg, nga ato që parashikohen në kushtet dhe kriteret e neneve 228, 229, 230 e vijuese të KPP-së. Njëkohësisht, gjykata duhet të mundësojë një gjykim ku të realizohet efektivisht verifikimi ezaurues, joformal, i “gjendjes së procedimit” në tërësi, pra i të gjitha rrethanave dhe kushteve thelbësore për ligjshmërinë e vazhdimit të zbatimit të masës së arrestit në burg, ku përfshihet edhe vlerësimi mbi dilijencën e posaçme – kujdesin dhe përpjekjet e dhura, të justifikueshme, të organit të prokurorisë për përmbushjen si në kohë, ashtu edhe në substancë të veprimeve betimore sipas ligjit, posaçërisht në raport me rrethanat e procedimit penal objekt i atij gjykimi.”* Nisur edhe nga përmbajtja e vendimit unifikues të lartpërmendur nxirret konkluzioni, se shqyrtimi periodik i masave të sigurimit përbën kontroll efektiv, ezaurues dhe joformal të gjendjes së procedimit në tërësi dhe ky verifikim kryhet në seancë gjyqësore, duke garantuar zhvillimin e debatit gjyqësor mes palëve mbi materialin e paraqitur. Vendimi unifikues nuk ka trajtuar çështjen e pjesëmarrjes së prokurorit në seancën gjyqësore të shqyrtimit të ankimimit në apel, gjë që ka sjellë mënyra të ndryshme të zbatimit të procedurës së shqyrtimit të këtyre kërkesave e që në praktikën aktuale gjyqësore janë interpretuar si raste të pavlefshmërive të gjykimit për shkak të mospjesëmarrjes së prokurorit.

27. Ndërkohë, kjo dispozitë (neni 246/6 i KPP-së), pas ndryshimit me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, aktualisht ka këtë formulim: *“6. Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Informacioni përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur prokurori nuk informon në afatin e përcaktuar, gjykata verifikon nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht. Gjikata, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi.”* Norma e ndryshuar synon të garantojë standardet e parashikuara nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, për sa i përket kontrollit gjyqësor periodik të kufizimit të lirisë personale, kur ndaj personit vijon të zbatohet një vendim arresti. Norma synon të disiplinojë kontrollin periodik të masave të sigurimit, me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së vijimit të zbatimit të masës së sigurimit, veçanërisht arrestit, duke u nisur nga natyra përjashtimore dhe e përkohshme e zbatimit të kësaj mase dhe domosdoshmëria për justifikimin kohë pas kohe të përshtatshmërisë (proporcionalitetit) të caktimit të kësaj mase.

28. Për arritjen e këtij qëllimi garantues në fushën e të drejtave dhe lirisë personale, ligjvënësi ka disiplinuar fillimisht detyrimin e organit të prokurorisë për të informuar gjykatën çdo dy muaj nga zbatimi i arrestit mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit dhe në rast mosveprimi të prokurorit ka vendosur detyrimin e gjykatës që edhe kryesisht (kur nuk ka kërkesë nga i pandehuri) të verifikojë nevojat e sigurimit. Gjithashtu, nëpërmjet kësaj norme disiplinohet procedura e gjykimit, nëpërmjet garantimit të së drejtës së palëve për t'u dëgjuar gjatë shqyrtimit të informacionit periodik, me qëllim ofrimin e të gjitha garancive të dhura në kontekstin e një gjykimi që ka për objekt verifikimin e nevojave të sigurimit lidhur me vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit të

arrestit që ka hequr/kufizuar lirinë e personit. Norma synon të garantojë të drejtën e personit për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur arsyet e tij lidhur me ligjshmërinë e vijimit të zbatimit të vendimit të arrestit, në kontradiktoritet të plotë me akuzën. Detyrimi i prokurorit për paraqitjen e informacionit, detyrimi për të marrë pjesë në seancë dhe pasoja e mospjesëmarrjes së tij në shqyrtimin e ankimit, duhen parë gjithmonë në funksion të garancive të gjykimit efektiv e sa më të shpejtë të kësaj natyre kërkesë.

29. Fjalja e parë e pikës 6 të nenit 246 të KPP-së vendos detyrimin e prokurorit për të informuar me shkrim gjykatën që ka caktuar masën. Teknika e ndërtimit të fjalisë: *“prokurori informon me shkrim gjykatën”*, në krahasim me atë para ndryshimeve: *“gjykata që ka dhënë vendimin duhet të informohet”*, synon që të theksojë pikë së pari detyrimin e prokurorit të paraqesë informacionin me shkrim para gjykatës. Qëllimi i ligjvënësit me këtë parashikim ligjor është që të evidentojë detyrimin e prokurorit për të informuar me shkrim periodikisht (çdo dy muaj) gjykatën për hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit (gjendjen e procedimit) në mënyrë që kjo e fundit të garantojë që kjo gjendje të bëhet objekt i shqyrtimit gjyqësor. Ky detyrim rrjedh nga fakti se organi i prokurorisë funksionin e tij në ushtrimin e ndjekjes penale duhet ta ushtrojë në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe ligjshmëria e vijueshmërisë së zbatimit të masës së sigurimit të arrestit të kërkuar prej vetë atij (prokurorisë) duhet t'i nënshtrohet kontrollit periodik gjyqësor.

30. Fjalja e dytë e pikës 6 të nenit 246 të KPP-së parashikon përmbajtjen e informacionit dhe ky parashikim ka mbetur i pandryshuar. Informacioni përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Ky parashikim është në funksion të përcaktimit në fjalinë e parë të nenit 246/6 të KPP-së, sipas së cilës: *“prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit.”* Nisur nga këto formulime është e qartë se ky informacion me shkrim nuk duhet të jetë formal në kuptimin që prokurori thjesht të listojë veprimet hetimore që ka kryer nga momenti që masa e arrestit është kërkuar *ab initio* në gjykatë. Përkundrazi, ky informacion, jo vetëm që duhet të përmbajë të dhëna mbi gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra, pra në tërësi lidhur me hetimet e kryera, por duhet të informojë gjykatën edhe lidhur me nevojat e sigurimit. Nevojat e sigurimit parashikohen në pikën 3 të nenit 228 të KPP-së dhe janë shtjelluar gjerësisht në vendimin njëses nr. 7, datë 14.10.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

31. Ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova në ngarkim të të hetuarit është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit, me të cilën kufizohet liria e të gjykuarit. Mirëpo, rrethanat e çështjes penale mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Sipas nenit 246/6 të KPP-së, gjykata duhet të shqyrtojë të gjitha rrethanat e lidhura me ekzistencën ose jo të interesit publik real që justifikon vazhdimin e zbatimit të masës së arrestit. Në këtë gjykim, ajo mban parasysh edhe respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, si dhe natyrën e masës së arrestit si përjashtim nga rregulli kushtetues i respektimit të lirisë individuale. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se për çdo periudhë paraburgimi, pavarësisht sa e shkurtër të jetë caktuar ajo, autoritetet duhet të parashtrojnë përpara gjykatës motive të besueshme që e justifikojnë atë periudhë (*Belchev kundër Bullgarisë*, 2004). Prandaj, informacioni me shkrim duhet të përmbajë, jo vetëm hetimet e kryera, por edhe motivacionet (arsyet/parashtrimet) e prokurorit lidhur me nevojat e sigurimit, nëse janë të tilla që justifikojnë vijimin e zbatimit të masës së arrestit dhe nuk cenojnë të drejtat e njeriut. Në këtë vështrim, paraqitja e informacionit me shkrim duke bërë thjesht një listim/përshkrim të veprimeve hetimore që janë kryer apo ato që do të kryhen, por pa u dhënë motivet konkrete për justifikimin e vazhdimin të kufizimit të lirisë së individit (nevojat e sigurimit), nuk përmbush kërkesat që neni 246/6 i KPP-së i vendos prokurorit dhe detyrimin e këtij të fundit për ushtrimin e ndjekjes penale në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

32. Megjithatë, në këtë gjykim, me objekt rivlerësimin e masës së arrestit, është gjykata ajo që duhet të çmojë e vendosë edhe në varësi të vërtetimit ose jo të motiveve të tjera të parashtruara me shkrim apo në gjykim nga organi i akuzës për justifikimin e vazhdimin të kufizimit të lirisë së individit. Prandaj, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 1, datë 8.1.2009, kanë unifikuar praktikën gjyqësore, se: *“Organi i prokurorisë ka barrën e provës për të vërtetuar përpara gjykatës se ende ka bazë të justifikuar për vijimin e zbatimit të masës së arrestit. Objekti i informacionit të detyrueshëm nga prokurori, parashtrimi i kërkesave të palëve për revokim a zëvendësim të masës së arrestit, si dhe objekti i gjykimit mund të shtrihen edhe përtej ekzistencës ose jo të motiveve fillestare që kanë justifikuar caktimin e masës së arrestit në burg, nga ato që parashikohen në kushtet dhe kriteret e neneve 228, 229, 230 e vijues të KPP-së. Në kuptim të pikës 6 të nenit 246 të këtij Kodi, në shqyrtimin gjyqësor dhe dhënien e vendimit për secilën çështje konkrete, gjykata nuk kufizohet vetëm në rrethanat që parashikohen në shkronjën “i” të pikës 2 të nenit 27 të Kushtetutës (shkronja “i” e pikës 1 të nenit 5 të Konventës), kryesisht të materializuara në nenet 228–230, si edhe në dispozitën e nenit 260 të KPP-së. Njëkohësisht, gjykata duhet të mundësojë një gjykim ku të realizohet efektivisht verifikimi ezaurues, joformal, i “gjendjes së procedimit” në tërësi, pra i të gjitha rrethanave dhe kushteve thelbësore për ligjshmërinë e vazhdimin të zbatimit të masës së arrestit në burg, ku përfshihet edhe vlerësimi mbi dilijencën e posaçme – kujdesin dhe përpjekjet e dubura, të justifikueshme, të organit të prokurorisë për përmbushjen si në kohë, ashtu edhe në substancë të veprimeve hetimore sipas ligjit, posaçërisht në raport me rrethanat e procedimit penal objekt i atij gjykimi. Kur vërtetohet në gjykim, në varësi të shkallës së mungesës së dilijencës në hetim, qoftë edhe vetëm për këtë shkak, gjykata mund të vendosë revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit. Në dhënien e këtij vendimi, gjykata duhet të mbajë parasysh edhe rrethanat e tjera të çështjes konkrete, të lidhura me kushtet e kriteret e parashikuara në ligj mbi caktimin e masave të sigurimit.”*

33. Më tej, kjo dispozitë (neni 246/6 i KPP-së), sipas formulimit në fuqi, përcakton rregullin se nëse prokurori nuk përmbush detyrimin për vënien në lëvizje të gjykatës nëpërmjet paraqitjes së informacionit për hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit, është gjykata që kryesisht ose me kërkesë të të pandehurit vihet në lëvizje për të verifikuar nevojat e sigurimit për personin ndaj të cilit është zbatuar masa e arrestit. Ky detyrim rrjedh nga fakti se rrethanat e çështjes mund të ndryshojnë me kalimin e kohës gjë që bën të domosdoshëm zbatimin e një mekanizmi të rishqyrtimit periodik, të detyrueshëm të masës së sigurimit nga ana e gjykatës, me qëllim që të çmohet nëse masa e arrestit vijon të jetë e justifikuar ligjërisht dhe nuk cenohen të drejtat e njeriut. Para ndryshimit të kësaj dispozite nuk parashikohej detyrimi i verifikimit kryesisht nga ana e gjykatës të nevojave të sigurimit, kur prokurori nuk përmbushte detyrimin e informimit dymujor, por ajo mund të vihej në lëvizje nga vetë personi i arrestuar. Për të garantuar kontradiktoritetin dhe mbrojtjen efektive, norma e ndryshuar ka përcaktuar detyrimin e gjykatës për të dëgjuar palët, përpara se të vendosë për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Ky parashikim është në përputhje me standardet e KEDNJ-së të elaboruara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, të cilat ndonëse nuk kërkojnë që një i ndaluar të dëgjohet sa herë që ai paraqet një ankim kundër mbajtjes së tij në paraburgim, ai duhet të ketë mundësinë që ta ushtrojë në intervale të arsyeshme të drejtën për t’u dëgjuar (*Çatal k. Turqisë*, pg. 33; *Altınok k. Turqisë*, pg. 45).

34. Norma e parashikuar në pikën 6 të nenit 246 të KPP-së nuk rregullon shprehimisht procedurën që kryen gjykata, në rastet kur ajo shqyrton ligjshmërinë e vijimit të zbatimit të masës së arrestit, gjatë verifikimit të detyrueshëm periodik. Para ndryshimit të normës në fjalë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë⁴ kanë përcaktuar se gjykata e shqyrton çështjen në seancë gjyqësore dhe duhet të vendosë me shpejtësi për marrjen e vendimit, qëndrim ky që është reflektuar edhe në ndryshimet që ka pësuar neni 246/6 i KPP-së. Nga ana tjetër, megjithëse kjo dispozitë nuk përcakton në përmbajtjen e saj procedurën që ndjek gjykata gjatë shqyrtimit periodik të masës së arrestit, ajo përcakton se gjykata merr vendim për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit, pasi ka dëgjuar palët. Për të përmbushur kërkesat e Konventës, kontrolli i gjyqtarit kombëtar duhet të respektojë si normat formale, ashtu edhe ato materiale të legjislacionit kombëtar, dhe të ushtrohet për

⁴ Shih vendimin unifikues nr. 1, datë 8.1.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

më tepër në përputhje me qëllimin e nenit 5: të mbrojë individin nga arbitrariteti⁵. Ndonëse procedura që lidhet me nenin 5/4 nuk duhet të shoqërohet gjithmonë me garanci të njëjta si ato që parashikon neni 6 për mosmarrëveshjet civile ose penale, ajo duhet të ketë një karakter gjyqësor dhe t'i ofrojë individit të interesuar garanci të përshtatura sipas natyrës së heqjes së lirisë për të cilën ai ankohet⁶. Për çdo person, ndalimi i të cilit i takon fushës së zbatimit të nenit 5/1, "c", kërkohet patjetër një seancë⁷. Procedura duhet të jetë me "ballafaqim" dhe ta garantojë në të gjitha rastet "barazinë e armëve" midis palëve.⁸ Barazia e mjeteve është një prej elementeve të pandashme nga nocioni i procesit të rregullt. Sipas nenit 6/1 të Konventës ajo kërkon që secilës palë t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të parashtruar argumentet e veta në kushte të cilat nuk e vënë atë në një situatë të pavolitshme në krahasim me kundërshtaren e vet⁹. Ndërsa, e drejta për një proces me ballafaqim sipas nenit 6 të Konventës nënkupton në parim që palëve t'u jepet mundësi për të marrë dijeni e për të bërë komente për të gjitha provat e paraqitura dhe të gjitha vërejtjet e parashtruara me synimin për të ndikuar mbi vendimin e gjykatës. Ajo është e lidhur ngushtë me parimin e barazisë së mjeteve dhe GJEDNJ-ja ka dalë ndonjëherë në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 6/1, duke i shqyrtuar së bashku të dyja nocionet. E drejta për një proces penal me ballafaqim nënkupton për akuzën, ashtu si për mbrojtjen, pasjen e mundësisë për t'u njohur me vërejtjet ose provat e paraqitura nga pala tjetër. Për më tepër, neni 6/1 kërkon që autoritetet proceduese t'i komunikojnë mbrojtjes të gjitha provat përkatëse, rënduese ashtu si lehtësuese, që kanë në zotërimin e tyre¹⁰. Ndërsa, sipas nenit 5/4 të Konventës, barazia e armëve nuk garantohej në qoftë se paditësit, ose avokatit të tij, i refuzohet qasja tek ato dokumente të dosjes hetimore, të cilat janë thelbësore për të kundërshtuar në mënyrë efektive ligjshmërinë e paraburgimit¹¹. Ndërkohë që mund të jetë e nevojshme për të mbajtur sekretin mbi disa të dhëna e prova në fazën e hetimit paraprak për të parandaluar që të dyshuarit të dëmtojnë dhënien e drejtësisë¹². Nganjëherë është, gjithashtu, thelbësore që i interesuari të ketë jo vetëm mundësinë për t'u dëgjuar personalisht, por edhe që ai të përfitojë nga ndihma efektive e avokatit të tij¹³. Parimet e ballafaqimit dhe të barazisë së armëve duhet të respektohen që të dyja edhe në apel¹⁴.

35. Prandaj, nisur nga këto detyrime konventore, duke pasur parasysh se veprimi i parimit të kontrollit gjyqësor mbi masën e arrestit mishërohet mes të tjerave edhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e nenit 246 të KPP-së, gjykata kompetente duhet të shqyrtojë me shpejtësi çështjen në seancë gjyqësore, duke dëgjuar palët. Lidhur me përmbushjen e këtij detyrimi (dëgjimin e palëve) përpara marrjes së vendimit, kjo dispozitë (neni 246/6 i KPP-së) përcakton se zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të KPP-së.

36. Objekti i normës së parashikuar nga neni 248 i KPP-së është rregullimi i procedurës që kryen gjykata, në rastet kur ajo vendos një masë sigurimi personal, shtrënguese ose ndaluese, pa e dëgjuar paraprakisht personin e dyshuar. Dispozita normon detyrueshmërinë e marrjes në pyetje të personit nga gjykata, kohën e marrjes në pyetje, garantimin e mbrojtjes dhe mundësitë e ndryshimit të vendimarrjes pas marrjes së provave të parashtruara nga personi që i është kufizuar liria. Me marrjen në pyetje të personit dhe dëgjimit të argumenteve të tij dhe të mbrojtësit, gjykata verifikon kushtet dhe kriteret e caktimit të masës dhe nevojat e sigurimit, të parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të këtij Kodi. Verifikimin e kushteve dhe kriterëve të caktimit të masës, si dhe nevojat e sigurimit, gjykata e kryen nëpërmjet marrjes në pyetje të personit ndaj të cilit është zbatuar masa,

⁵ GJEDNJ, *Koendjibiharie k. Vendeve të Ulëta*, pg. 27.

⁶ GJEDNJ, *A. me të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, pg. 203; *Idalov k. Rusisë*, pg. 161.

⁷ GJEDNJ, *Nikolova k. Bullgarisë*, pg. 58.

⁸ GJEDNJ, *Reinprecht k. Austrisë*, pg. 31; *A. me të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar*, pg. 204.

⁹ GJEDNJ, *Foucher k. Francës*, pg. 34; *Bulut k. Austrisë*; *Bobek k. Polonisë*, pg. 56; *Klimentyev k. Rusisë*, pg. 95.

¹⁰ GJEDNJ, *Rowe e Davis k. Mbretërisë së Bashkuar*, pg. 60.

¹¹ GJEDNJ, *Ovsjannikov k. Estonisë*, pg. 72; *Fodale k. Italisë*; *Korneykova k. Ukrainës*, pg. 68.

¹² GJEDNJ, *Garcia Alva kundër Gjermanisë*, 2001.

¹³ GJEDNJ, *Cernák k. Sllovakisë*, pg. 78.

¹⁴ GJEDNJ, *Çatal k. Turqisë*, pg. 33-34.

duke proceduar personalisht me pyetjen e tij. Natyrisht, personi ka të drejtë të mos përgjigjet, si dhe të bëjë deklaratimet që i çmon të nevojshme për mbrojtjen e tij. Norma në fjalë, në pikën 3 të saj parashikon, se: *“Në pyetjen e të arrestuarit marrin pjesë prokurori dhe mbrojtësi, të cilët lajmërohen nga sekretaria e gjykatës.”* Gjatë debatit gjyqësor palët kanë të drejtë të paraqesin prova, me përjashtim të provave me dëshmitarë. Kësisoj, qartazi kuptohet se marrja në pyetje bëhet në seancë gjyqësore, në të cilën marrin pjesë, përveç të arrestuarit, prokurori dhe mbrojtësi, kundrejt njoftimit paraprak nga sekretaria e gjykatës.

37. Ndërkohë, megjithëse norma e zbatueshme në çështjen e shtruar për njësim, pika 6 e nenit 246 të KPP-së, nuk rregullon shprehimisht procedurën që kryen gjykata, në rastet kur ajo shqyrton ligjshmërinë e vijimit të zbatimit të masës së arrestit gjatë verifikimit të detyrueshëm periodik, ajo përcakton se gjykata merr vendim për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit, pasi ka dëgjuar palët. Dëgjimi i palëve nënkupton detyrimin e gjykatës që t'u sigurojë palëve në proces të drejtën për t'u paraqitur në seancë gjyqësore kundrejt njoftimit paraprak, njohjen me provat, të drejtën për të paraqitur argumentet/provat dhe për të kundërshtuar ato të palës tjetër. Në referim të nenit 246/6 të KPP-së gjykata duhet të dëgjojë si prokurorin (arsyet e vazhdimit të paraburgimit), ashtu edhe argumentet e mbrojtjes, dhe t'u japë mundësi të dyja palëve të paraqesin prova, apo të kundërshtojnë të dhënat e paraqitura. Dëgjimi i palëve është një parim thelbësor për të garantuar një proces të drejtë dhe kontradiktor dhe çdo shkelje e tij e cenon ligjshmërinë e vendimmarrjes së dhënë. Nisur nga ky detyrim, por edhe sepse fjalia e fundit e pikës 6 të nenit 246/6 referon në rregullat e parashikuara në nenin 248 të KPP-së, gjykimi i verifikimit të detyrueshëm periodik për ligjshmërinë e vijimit të zbatimit të masës së arrestit në shkallë të parë, do të bëhet në seancë gjyqësore, në të cilën marrin pjesë, përveç të arrestuarit, prokurori dhe mbrojtësi, kundrejt njoftimit paraprak nga sekretaria e gjykatës.

38. Ndërkohë, objekti i normës së parashikuar nga neni 249 është rregullimi i mjeteve të ankimit kundër vendimit të gjykatës për masat e sigurimit sipas neneve 244 dhe 248 të KPP-së, kohëzgjatjen e afatit të paraburgimit (mbi 6 muaj), afatet brenda të cilit duhet të paraqitet dhe shqyrtohet ankimi, rregullat që duhet të ndiqen për njoftimin e palëve, si dhe alternativat e vendimmarrjes. Qëllimi i normës është që t'u garantojë të gjithë palëve (të pandehurit dhe mbrojtësit, prokurorit) një mjet të shpejtë, efektiv dhe të drejtën për rishqyrtim. Sipas nenit 249, pika 1/1, *“Kundër vendimit të gjykatës për vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit, sipas nenit 248 të këtij Kodi, prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim brenda pesë ditëve.”* Pika 1/1 (shtuar me ligjin nr. 35/2017), ka zgjeruar subjektet që mund të bëjnë ankim kundër vendimit për vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit (sipas nenit 248 të KPP-së), duke njohur prokurorin jo vetëm si subjekt procedural, por edhe si palë aktive në fazën e ankimit. Ky parashikim synon të garantojë barazinë e armëve, në kuptimin që të gjitha palët të kenë mundësi të njëjta ankimi. Sipas paragrafit 3 të nenit 249 të KPP-së, ankimi paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin. Brenda 3 ditëve nga realizimi i njoftimeve, sekretaria dorëzon aktet (dosjen) në gjykatën që do të shqyrtojë ankimin (gjykatën e apelit). Ky parashikim siguron vazhdimësinë procedurale (shqyrtimin e çështjes) pa vonesa administrative. Norma në fjalë nuk rregullon ritin që zbatohet në apel gjatë shqyrtimit të ankimit ndaj vendimit për masat e sigurimit, në kuptimin nëse gjykimi do të zhvillohet në seancë gjyqësore apo në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh. Megjithatë, në paragrafin e katërt të nenit 249 parashikohet, se: *“Data e caktuar për seancën i njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të paktën tri ditë përpara”*. Nisur nga parashikimi, se: *“Data e caktuar për seancën”* del se shqyrtimi i ankimit në apel do të bëhet në seancë dhe data e saj (seancës) duhet t'i njoftohet të paktën tri ditë përpara prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij. Arsyeja lidhet me dhënien e kohës së mjaftueshme për përgatitje dhe ushtrim real të së drejtës për t'u dëgjuar. Në mungesë të rregullimeve të posaçme për ritin e gjykimit që duhet të ndiqet për shqyrtimin e ankimeve në lëndë të masave të sigurimit personal, referim do të bëhet në rregullimet e përgjithshme që normojnë seancën gjyqësore në apel: nenin 426/a të KPP-së. Masat e sigurimit personal caktohen në dhomë këshillimi si rregull, sipas nenit 244 të KPP-së dhe verifikohen në seancë

gjyqësore me pjesëmarrjen e palëve, sipas nenit 248 të KPP-së. Kundër secilit prej këtyre vendimeve mund të apelohej, sipas nenit 249 të KPP-së. Kur ankimohet vendimi për verifikimin e masës së sigurimit personal, shqyrtimi gjyqësor në apel do të zhvillohet në seancë gjyqësore dhe si rregull në prani të palëve, diktuar nga neni 248 të KPP-së, i cili parashikon zhvillimin e seancës me praninë e palëve (prokurorit dhe mbrojtësit). Për rrjedhojë, pika 3 e nenit 248 të KPP-së do të zbatohet në mënyrë plotësuese edhe për ritin e gjykimit në shkallë të parë edhe në gjykimin në apel, sipas pikës 5 të nenit 426/a të KPP-së¹⁵. Në këtë kuptim, edhe ankimi kundër vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë, sipas nenit 246/6 të KPP-së për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit, do të shqyrtohet në seancë gjyqësore dhe si rregull me pjesëmarrjen e personit ndaj të cilit është zbatuar masa e sigurimit personal, mbrojtësit dhe prokurorit, sipas neneve 246/6, 248, 249 dhe 426/a, pika 5, të KPP-së.

39. Në sintezë të arsyetimit deri në këtë pikë të vendimit, Kolegji thekson se në zbatim të parashikimeve të mësipërme ligjore dhe vendimit njësuës nr. 1/2009, shqyrtimi periodik i ligjshmërisë së zbatimit të masës së sigurimit të arrestit me kërkesë të palëve ose kryesisht nga gjykata, do të kryhet në seancë gjyqësore, me pjesëmarrjen e palëve (prokurorit dhe mbrojtësit), duke u dhënë mundësinë për t'u dëgjuar në një procedurë me ballafaqim dhe me barazi të armëve, në përfundim të së cilës gjykata do të vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Nga ana tjetër, nisur nga çështja konkrete objekt njësimi, sillet në vëmendje se as neni 246/6 i KPP-së dhe as nenet 248 dhe 249 në të cilat referon kjo dispozitë, nuk parashikojnë pasojën ligjore të mosparaqitjes së palëve në seancën gjyqësore që zhvillohet sipas këtyre dispozitave. Megjithatë, neni 246/6 lidhur me rregullat për zbatim referon në nenet 248 dhe 249 të KPP-së. Nga përmbajtja e nenit 248 të KPP-së vërehet se ligjvënësi parashikon pjesëmarrjen e mbrojtësit dhe prokurorit, por nuk përcakton nëse kjo pjesëmarrje është e domosdoshme/detyrueshme, sikundër parashikon për shembull në rastin e zhvillimit të seancës së vlefshëmimit të arrestit/ndalimit (neni 259/1¹⁶), seancën paraprake (neni 332/b, pika 1¹⁷), gjykimin në themel¹⁸, gjykimin me marrëveshje¹⁹, gjykimet në fazën e ekzekutimit.²⁰ Këtu duhet evidentuar një dallim: KPP-ja sanksionon me pavlefshmëri absolute, kur nuk respektohen dispozitat për pjesëmarrjen e mbrojtësit, vetëm kur prania e tij është e detyrueshme, ndërsa lidhur me prokurorin kur cenohet pjesëmarrja e tij në procedim.

40. Në një vështrim krahasues²¹ (për shkak se KPP-ja shqiptare është ndërtuar mbi bazën e modelit italian), sillet në vëmendje se në varësi nga rëndësia e interesit që mbron norma e shkelur, ligji procedural penal italian dallon tre tipa pavlefshmërisë: absolut, relativ dhe i ndërmjetëm. Pavlefshmëritë absolute parashikohen në nenin 179 të KPP-së italiane, e cila referon pjesërisht edhe në nenin 178. Ata u referohen subjekteve kryesore të procedimit, ngrihen edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit dhe nuk mund të korrigjohen. I vetmi korrigjim i tyre ka natyrë automatike kur vendimi penal merr formë të prerë²². Parashikohen tri raste të pavlefshmërisë absolute, të cilat

¹⁵ Neni 426/a: “5. Në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë.”

¹⁶ Neni 259/1 i KPP-së: “1. Seanca e vlefshëmimit zhvillohet me pjesëmarrjen e **domosdoshme** të prokurorit dhe të mbrojtësit. Kur mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar kryesisht nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, gjykata cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër.”

¹⁷ Neni 332/b/1 i KPP-së: “1. Seanca zhvillohet me detyrë të mbyllura, me pjesëmarrjen e **domosdoshme** të prokurorit dhe të mbrojtësit të të pandeburit.”

¹⁸ Neni 348/3 i KPP-së: “3. Nëse prokurori nuk paraqitet në gjykim, gjykata shtyn seancën dhe njofton drejtuesin e prokurorisë.” Për mbrojtjen, zhvillimi i gjykimit në praninë e saj është i detyrueshëm, vetëm në rastet e parashikuara në nenin 49 të KPP-së, që parashikon situatat kur mbrojtja është e detyrueshme.

¹⁹ Neni 406/dh/2 i KPP-së: “2. Gjykata e shqyrtën kërkesën në seancë gjyqësore, brenda tridhjetë ditëve nga paraqitja e saj. Seanca zhvillohet me praninë e **detyrueshme** të prokurorit, të pandeburit dhe mbrojtësit të tij.”

²⁰ Neni 471/4 i KPP-së: “4. Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e **detyrueshme** të prokurorit dhe të mbrojtësve. I interesuari, kur e kërkon, dëgjohej personalisht ose me letërporosi.”

²¹ “Manuale di Procedura Penale”, Paolo Tonini, Carlotta Conti, Giuffrè 2023, faqe 223 e vijuese; Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Italisë.

²² Theksohet këtu, se, sipas ligjit italian, vendimi penal merr formë të prerë pas shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e

lidhen me mosrespektimin e dispozitave, që kanë të bëjnë me: i. kushtet e zotësisë së përgjithshme të gjyqtarit për të ushtruar funksione juridiksionale, si dhe numrin e gjyqtarëve të domosdoshëm për formimin e kolegjeve (neni 179/1 në lidhje me nenin 178/1, shkronja “a”); ii. nismën e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale (por jo pjesëmarrjen e tij në procedim – sikundër parashikohet në nenin 128/a/1, b) të KPP shqiptar) – neni 179/1; iii. thirrjen e të pandehurit ose praninë e mbrojtësit në rastet kur ajo është e detyrueshme (neni 179/1); si dhe iv. në çdo rast tjetër kur pavlefshmëria absolute parashikohet nga një dispozitë e posaçme e ligjit. Ndërsa, pavlefshmëritë e ndërmjetme parashikohen në nenin 180 të KPP-së italiane, me titullin “pavlefshmëri të tjera”. Në dallim nga pavlefshmëritë e tipit absolut, pavlefshmëritë e ndërmjetme ngrihen edhe kryesisht (sikundër pavlefshmëritë absolute), por brenda afatesh kohore të kufizuara, si dhe janë të korrigjueshme. Pavlefshmëritë e ndërmjetme lidhen me mosrespektimin e dispozitave që kanë të bëjnë, për shembull, me pjesëmarrjen e prokurorit në procedim (pra, edhe para fillimit të shqyrtimit gjyqësor), sikurse rasti kur cenohet parimi i kontradiktoritetit kundrejt tij (për shembull, mungesa e njoftimit të datës së seancës paraprake); mosmarrja e mendimit të tij kur ligji e parashikon (për shembull, për qëllim të revokimit ose zëvendësimit të masave të sigurimit – neni 299) etj.; mosthirrjen në gjykim të palëve private, të ndryshme nga i pandehuri etj. Ndërkohë, pavlefshmëritë relative, që parashikohen nga neni 181 i KPP-së italiane, janë ato që nuk përfshihen në pavlefshmëritë absolute dhe të ndërmjetme; deklarohen me kërkesë të palës së interesuar, brenda afatesh kohore të shkurtra dhe janë të korrigjueshme.

41. Duke u mbështetur në modelin italian të procedurës penale, ligjvënësi shqiptar i lidh rastet e pavlefshmërive absolute, të përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 128/a, vetëm me subjektet kryesore të procedimit: me gjyqtarin (shkronja “a”), me prokurorin (shkronja “b”) dhe me të pandehurin e mbrojtësin e tij, si dhe viktimën (shkronja “c”). Ajo që ka rëndësi për çështjen e shtruar për njësim, lidhet me rastin e pavlefshmërisë absolute të parashikuar në shkronjën “b” të nenit 128/a, pika 1 të KPP-së. Kjo dispozitë parashikon, se: *“1. Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me: b) të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim;”*. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rezulton se pavlefshmëria absolute e lidhur me prokurorin, mund të ngrihet apo të konstatohet në dy raste: i. kur cenohet e drejta e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale; ii. kur cenohet pjesëmarrja e tij në procedim.

42. Prokurori është subjekti i vetëm që Kushtetuta dhe ligji procedural penal i njeh pushtetin për të ushtruar ndjekjen penale. Lidhur me kuptimin e “ushtrimit të ndjekjes”, ndonëse Kodi nuk përmban një përkufizim të qartë për këtë institut, sillet në vëmendje se në përfundim të hetimeve paraprake, nëse prokurori vlerëson se provat e grumbulluara gjatë hetimeve janë të mjaftueshme për të provuar se fakti penal ka ndodhur dhe se ai është kryer nga i pandehuri, paraqet para gjykatës kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq (nenet 327/6, shkronja “b”, dhe 331 të KPP-së). Ky moment konkretizon ushtrimin e ndjekjes penale dhe nënkupton detyrimin e prokurorit që në përfundim të hetimeve të procedojë me një nga mënyrat e parashikuara në ligj, në zbatim të nenit 327, pika 6, të KPP-së (shih vendimin njëses nr. 00-2024-2161 (167), datë 4.7.2024, të KPGJL-së). Me ndryshimet kushtetuese me ligjin nr. 76/2016, reflektuar dhe në KPP (me ligjin nr. 35/2017), kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq e paraqitur nga prokurori në përfundim të hetimeve paraprake (përmbajtja e së cilës pasqyron në thelb akuzën e kontestuar prej këtij të fundit të hetuarit, i cili prej këtij momenti “fiton” statusin e të pandehurit, duke u akuzuar për një akuzë të caktuar), i nënshtrohet kontrollit dhe verifikimit nga gjyqtari i seancës paraprake (shih vendimin njëses nr. 62, datë 1.11.2021, të KPGJL-së). Në këtë vështrim nocioni “ushtrim i ndjekjes penale” materializohet në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq të paraqitur nga prokurori në përfundim të hetimeve paraprake. Praktika gjyqësore shqiptare lidhur me rastet kur është cenuar e drejta e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale, ka cilësuar si të tilla, për shembull, kur gjykata nuk ka ndryshuar cilësimin ligjor, por ka ngritur akuzë të re²³, kur gjykata prish

Kasacionit.

²³ Shih vendimin nr. 00-2011-1106, datë 27.12.2011, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

vendimin për shkak të mosmarrjes nën hetim të një personi tjetër²⁴, kur hetimet në ngarkim të njërit prej të pandehurve kanë vijuar pa u shfuqizuar paraprakisht vendimi i pushimit të çështjes në ngarkim të tij dhe personi deklarohet fajtor²⁵ etj.

43. Sipas nenit 128/a, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, pavlefshmëria absolute e akteve që lidhen me prokurorin, mund të ngrihet, apo konstatohet, edhe në rastin kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me pjesëmarrjen e tij në procedim. Konstatohet se ligjvënësi shqiptar me këtë parashikim i është shmangur modelit italian, kur ka vendosur të sanksionojë me pavlefshmëri absolute edhe raste të kësaj natyre. KPP-ja italiane, raste të kësaj natyre i sanksionon me pavlefshmëri absolute, por të natyrës ndërmjetëse, që do të thotë se pavlefshmëri të tilla janë të korrigjueshme dhe megjithëse mund të konstatohen kryesisht ose me kërkesë të palës, ngritja e tyre kushtëzohet me respektimin e afateve. Qëllimi i ligjvënësit shqiptar me sanksionimin e këtij rasti me pavlefshmëri absolute duket se ka qenë për të garantuar jo vetëm pjesëmarrjen fizike të detyrueshme të përfaqësuesit të akuzës në seancë, por edhe detyrimin e tij për të mbajtur qëndrim të shprehur lidhur me të gjitha çështjet që janë objekt shqyrtimi para gjykatës. Sistemi procedural penal shqiptar është më i ngurtë, ai nuk lejon hapësirë për zgjedhje dhe dikton pjesëmarrje të domosdoshme të prokurorit në procedim, në çdo rast kur ligji parashikon zhvillimin e seancës me pjesëmarrjen e tij. Pjesëmarrja e prokurorit në procedim, në një proces palësh, është shumë e rëndësishme, veçanërisht kur gjykata shqyrton ligjshmërinë e vijueshmërisë së masës së arrestit, masë kjo e caktuar bazuar në kërkesën e paraqitur nga prokurori, i cili ka detyrim që të informojë gjykatën lidhur me mënyrën dhe dilijencën që ka ushtruar veprimtarinë e tij hetimore, saktësinë e tyre, marrë parasysh edhe kompleksitetin dhe karakteristikat e veçanta të çështjes²⁶, në raport edhe me pretendimet e personit të arrestuar, por edhe në drejtim të qëndrimit të tij mbi rrethanat që lidhen me ekzistencën ose jo të interesit publik real, që justifikon vazhdimin e zbatimit të kësaj mase sigurimi personal.

44. Sipas nenit 128/a, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së pavlefshmëria absolute e akteve që lidhen me prokurorin, mund të ngrihet, apo të konstatohet edhe në rastin kur nuk respektohen dispozitat që parashikojnë pjesëmarrjen e tij në procedim. Krahasimisht me legjislacionin penal italian, ndërsa KPP-ja italiane sanksionon me pavlefshmëri absolute cenimin e nismës së prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale (neni 179/1), KPP-ja shqiptare sanksionon me pavlefshmëri absolute jo vetëm cenimin e së drejtës së prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale, por edhe cenimin e pjesëmarrjes së tij në procedim (shih nenin 128/a/1, b) të kodit shqiptar), sigurisht kur ligji parashikon zhvillimin e seancës me pjesëmarrjen e tij. Sikurse është thënë më lart, si neni 246/6 ashtu edhe neni 249 i KPP-së lidhur me rregullat për zbatim referojnë në nenin 248 të KPP-së, dispozitë kjo që në pikën 3 parashikon se në pyetjen e të arrestuarit marrin pjesë prokurori dhe mbrojtësi, të cilët lajmërohen nga sekretaria e gjykatës. Në këto kushte, duke qenë se zgjedhja e ligjvënësit ka qenë që rregullat e parashikuara në nenin 248 dhe 249 të KPP-së të zbatohen edhe në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6 të KPP-së, gjykata ka detyrimin të garantojë pjesëmarrjen e prokurorit edhe në këtë gjykim nëpërmjet njoftimit të tij të rregullt paraprak për datën e seancës.

45. Mirëpo, sipas nenit 128/a, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, pavlefshmëria absolute e akteve që lidhen me prokurorin mund të ngrihet, apo konstatohet, vetëm në rastin kur nuk respektohen dispozitat që parashikojnë pjesëmarrjen e tij në procedim. Neni 246/6 i KPP-së ka përcaktuar se gjykata vendos pasi dëgjon palët, ndërsa lidhur me procedurën që duhet të zbatohet në gjykimin në shkallë të parë, referim duhet të bëhet në rregullat e parashikuara në nenin 248 të KPP-së, dispozitë kjo që parashikon zhvillimin e seancës me pjesëmarrjen e prokurorit dhe mbrojtësit. Si rrjedhojë, duke qenë se zgjedhja e ligjvënësit ka qenë që rregullat e parashikuara në nenin 248 të KPP-së të zbatohen

²⁴ Shih vendimin nr. 00-2012-1333 (251), datë 3.10.2012, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Kolegji ritheksoi jurisprudencën e mëparshme, se është e drejtë e prokurorit të formulojë akuzë dhe të ushtrojë ndjekjen, ndaj mosveprimi i tij nuk përbën shkak për pavlefshmëri absolute.

²⁵ Shih vendimin nr. 282, datë 15.3.2007, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

²⁶ *Shabani k. Zvicrës*, GJEDNJ, 2007.

edhe në gjykimin në shkallë të parë të verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP-së, pjesëmarrja e prokurorit edhe në këtë gjykim është e detyrueshme dhe në rast mosrespektimi, sipas nenit 128/a, pika 1, shkronja “b” të KPP-së, sanksionohet me pavlefshmëri absolute të aktit (vendimit).

46. Ndërkohë, sipas nenit 249, pika 1/1, të KPP-së parashikohet, se: *“kundër vendimit të gjykatës për vazhdimin, revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit... prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim brenda pesë ditëve.”* Pra, ligji e njeh prokurorin jo vetëm si subjekt, por edhe si palë aktive në fazën e ankimit. Ndërsa, neni 426/a/1 i KPP-së, urdhëron, që: *“kryetari i trupit gjykues kontrollon paraqitjen e palëve. Në rast se palët nuk janë paraqitur, kryetari verifikon nëse njoftimet janë të rregullta dhe nëse mungesa është e justifikuar.”* Kjo tregon se prokurori, si një nga palët e procesit, duhet të jetë thirrur dhe është e pritshme të marrë pjesë në seancë. Megjithatë, prania fizike e prokurorit në seancën e apelit për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit për masën e sigurimit personal nuk është e detyrueshme, në kuptimin që pasi, të jetë njoftuar rregullisht, mungesa e tij e pajustificuar nuk e ndalon zhvillimin e seancës dhe nuk e bën nul vendimin. Vetëm kur ligji kërkon (parashikon) zhvillimin e seancës me pjesëmarrjen e prokurorit, mungesa e tij shkakton pavlefshmëri absolute sipas nenit 128/a të KPP-së, pasi cenon pjesëmarrjen e tij në procedim. Është e vërtetë, se pika 5 e nenit 426/a të KPP-së parashikon se në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh dispozitat mbi procedurën e gjykimin në shkallë të parë (në rastin konkret neni 248), por nga ana tjetër kjo procedurë kufizohet për aq sa është e zbatueshme në apel, në raport edhe me natyrën e kërkesës objekt gjykimi (masë sigurimi personal).

47. Detyrimi i gjykatës së apelit në gjykimin e ankimeve ndaj masës së sigurimit personal është të bëjë njoftimin e palëve (neni 249/4) dhe verifikimin e rregullsisë së tij (neni 426/a/1). Nëse njoftimi ka qenë i parregullt, seanca shtyhet derisa të bëhen njoftimet e rregullta. Nëse njoftimi ka qenë i rregullt, por prokurori nuk paraqitet pas asnjë shkak të ligjshëm, gjykata e apelit mund të vazhdojë dhe të marrë vendim, duke e konsideruar mungesën si heqje dorë nga e drejta për t’u dëgjuar. Në këtë vështrim, por edhe referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, e cila ka konsideruar në pajtim me nenin 5/4 të Konventës, rastin kur palët janë paraqitur dhe dëgjuar në shkallë të parë, por jo në gjykimin në apel, prania e prokurorit në gjykimin në apel, nuk është e detyrueshme.

48. Në arritjen e këtij përfundimi mbahet në konsideratë nga ana tjetër edhe fakti i rëndësishëm që ky gjykim (në apel) vihet në lëvizje jo kryesisht (sikurse ndodh në gjykimin në shkallë të parë – neni 246/6), por vetëm me iniciativën e palëve (nëpërmjet paraqitjes së ankimit), duke i mbetur kështu zgjedhja atyre (palëve), nëse duan apo jo të marrin pjesë në gjykim. Përmbushja e detyrimit për thirrjen dhe dëgjimin e palëve gjatë gjykimin në shkallë të parë, si dhe njoftimi i palëve për datën e seancës në gjykimin në apel, duke u dhënë mundësinë për t’u paraqitur dhe për t’u dëgjuar, garanton standardet e vendosura nga KEDNJ-ja, në kuadër të respektimit të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Fakti që palët zgjedhin të mos paraqiten në procedurën e apelit, gjykim që inicohet dhe kufizohet nga ankimi (brenda shkaqeve të tij), nuk justifikon zvarritjen e gjykimin dhe për pasojë mosparaqitja e palëve nuk e pengon shqyrtimin e ankimit për vendimin e masës së sigurimit personal nga ana e gjykatës së apelit, brenda afateve të arsyeshme. Kusht *sine qua non*, në këtë rast është që ato (palët) të njoftohen rregullisht për seancën (neni 249/4), si dhe në eventualitet për çdo memorie/akt/apel kundërshtues, apo qëndrim që sjell elemente të reja në proces, me qëllim respektimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në gjykim. Nga ana tjetër, fakti që zhvillimi i seancës në apel, pa pjesëmarrjen e prokurorit nuk sanksionohet me pavlefshmëri absolute, nuk do të thotë që prokurori duhet të jetë indiferent.

49. Mundësia që gjykata e apelit, sipas pikës 6 të nenit 249 të KPP-së, të vendosë sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit edhe për arsye të ndryshme nga ato që janë parashtruar ose nga ato që tregohen në pjesën arsyetuese të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, sigurisht që evidenton rëndësinë që ka pjesëmarrja e prokurorit edhe në gjykimin në apel, sepse vendimi mund të bazohet mbi argumente shtesë ose të tjera nga ato që palët kanë dhënë fillimisht.

Prandaj mungesa e një sanksioni procedural lidhur me mosparaqitjen e prokurorit në apel, duhet të kuptohet në sensin logjik se akuzuesi, duke mbajtur detyrimin e barrës së provës, është i lirë të bëjë zgjedhjet e tij të përgjegjshme, në lidhje me pjesëmarrjen në procedim, duke qenë i detyruar që të përmbushë, jo vetëm të drejtën që lidhet me ushtrimin e ndjekjes penale, por edhe detyrimin që funksionin e tij në ushtrimin e ndjekjes penale ta ushtrojë në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke dhënë motive konkrete që justifikojnë vazhdimin e kufizimit të lirisë së individit (nevojat e sigurimit), si pasojë e masës së arrestit të kërkuar prej vetë atij (prokurorisë).

50. Për sa më lart, duke qenë se zgjedhja e ligjvënësit ka qenë që rregullat e parashikuara në nenin 249 të KPP-së të zbatohen edhe në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP-së, gjykata e apelit ka detyrimin të garantojë pjesëmarrjen e prokurorit edhe në këtë gjykim nëpërmjet njoftimit të tij të rregullt paraprak për datën e seancës. Mandej, pjesëmarrja e prokurorit në seancën gjyqësore që zhvillohet në apel, si organ që ka barrën e akuzës dhe motivimit për rastin konkret të nevojave të sigurimit për vijueshmërinë e zbatimit të arrestit (të kërkuar prej tij), është zgjedhja e tij e lirë, përkundrajt së cilës nuk mund të veprojë sanksioni procedural i pavlefshmërisë absolute të aktit (vendimit të gjykatës). Nocioni i pjesëmarrjes së prokurorit në seancën në apel dhe pavlefshmëria që buron prej saj lidhet drejtpërsëdrejti me detyrimin e njoftimit të tij (shih nenin 249/4 të KPP-së), në mënyrë që të ketë mundësinë reale të ushtrojë funksionet, por jo edhe me rastet kur ai nuk dëshiron të përfitojë nga kjo mundësi. Parashikimi në nenin 246/6 të KPP-së, se gjykata merr vendim pasi dëgjon palët, në raport me gjykimin që zhvillohet në shkallë të dytë, lidhet posaçërisht me detyrimin e saj (gjykatës së apelit) për t'i njoftuar palët rregullisht, me qëllim që procedura të jetë me ballafaqim dhe të garantojë në të gjitha rastet “barazinë e armëve” midis palëve edhe në këtë shkallë të gjykimit, por jo me “paralizimin” e procesit të rishikimit, kur palët me vullnetin e tyre të lirë zgjedhin të mos paraqiten në seancë.

51. Lidhur me sa më lart, sillet në vëmendje se këto kërkesa duhet të shqyrtohen sa më shpejt, pasi kanë të bëjnë me kontrollin e respektimit të garancive në kushtet e kufizimit të lirisë personale e këto çështje duhet të zgjidhen brenda afateve të shpejta, standard i vendosur në KEDNJ, jurisprndencën e GJEDNJ dhe praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Në këtë kontekst dhe pjesëmarrja e palëve është në funksion të përmbushjes së garancive për kontrollin e zbatimit të lirisë personale të personit gjatë zbatimit të masave të sigurimit. Për të verifikuar nëse është respektuar kërkesa për afat të shkurtër që kërkon neni 5/4, mund të merren në konsideratë disa elemente të krahasueshme me ato që luajnë rol në shqyrtimin e kërkesës për proces brenda një afati të arsyeshëm në fushën e neneve 5/3 dhe 6/1, për shembull shpejtësia e treguar nga autoritetet, zvarritjet e shkaktuara nga i ndaluari, si edhe çdo lloj elementi tjetër që ka sjellë një vonesë e që nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi (*Mooren k. Gjermanisë*, pg. 106; *Kolompar k. Belgjikës*, pg. 42). Në qoftë se koha e shpenzuar për të marrë vendim është *a priori* e papajtueshme me kërkesën për shpejtësi, GJEDNJ-ja do t'i kërkojë shtetit që të japë shpjegime për këto ngadalësi ose që t'i përligjë ato me arsye të jashtëzakonshme (*Musial k. Polonisë*, pg. 44; *Koendjbibarie k. Vendeve të ulëta*, pg. 29). Kësisoj, mospjesëmarrja e vullnetshme e prokurorit në gjykimin në apel, duke qenë një zgjedhje e tij e lirë, nuk mund të sanksionohet me pavlefshmëri absolute të vendimit, pasi një interpretim i gjerë i rasteve të pavlefshmërisë absolute, që lidhen me pjesëmarrjen e prokurorit në procedim, duke e shtrirë në të dyja shkallët e gjykimit mund të shkaktonte që koha e shpenzuar nga gjykata për të marrë vendim të ishte e papajtueshme me kërkesën për shpejtësi që kërkojnë standardet e Konventës.

52. Pavarësisht logjikës së argumentit të Prokurorisë së Posaçme dhe Prokurorisë së Përgjithshme, se për rastet kur zgjedhja ka qenë për të zhvilluar seancën pa pjesëmarrjen e palëve ligjvënësi e ka parashikuar shprehimisht sikurse në nenin 261/3 të KPP-së, duhet thënë nga ana tjetër se qëllimi i ligjvënësit në vendosjen e detyrimit për të dëgjuar palët sipas nenit 246/6 të KPP-së merr vlerë në gjykimin në shkallë të parë (referuar specifikës së gjykimit në shkallë të parë), por nuk mund të shërbejë si shkak që të legjitimojë situatat “absurde” të ndodhura në praktikë, ku palët nuk paraqiten në gjykimin në apel të iniciuar mbi vullnetin e tyre, duke shkaktuar kështu zvarritje të gjykimit. Qëllimi i kësaj

dispozite ka qenë garantimi i mundësisë së palëve për t'u dëgjuar para se gjykata të marrë vendim për vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit dhe jo zvarritja e gjykimit në apel, në rastet kur palët nuk dëshirojnë të përfitojnë nga e drejta për t'u dëgjuar në gjykimin rishikues. Sikurse u evidentua edhe më lart, prania e këtyre subjekteve (prokurorit dhe mbrojtësit) në gjykimin në apel, edhe në referim të jurisprudencës së GJEDNJ-së *(e cila ka konsideruar në pajtim me nenin 5/4 të Konventës, rastin kur palët janë paraqitur dhe dëgjuar në shkallë të parë por jo në procedurën e apelit)* nuk është e detyrueshme edhe për një arsye tjetër.

53. Gjykimi (në apel) vihet në lëvizje jo kryesisht, por vetëm me iniciativën e palëve (nëpërmjet paraqitjes së mjetit të ankimit), duke i mbetur kështu zgjedhja atyre, nëse duan apo jo të marrin pjesë në gjykim. Fakti që palët zgjedhin të mos paraqiten në gjykimin e apelit, gjykim që inicohet dhe kufizohet nga ankimi (brenda shkaqeve të tij), nuk justifikon zvarritjen e gjykimit dhe për pasojë mosparaqitja e palëve nuk pengon shqyrtimin e ankimit nga ana e gjykatës së apelit brenda afateve të arsyeshme. Kusht *sine qua non*, sikurse u theksua edhe më lart, është që ato (palët) të njoftohen rregullisht për seancën në apel (neni 249/4), si dhe në eventualitet për çdo memorie/akt/apel kundërshtues, apo qëndrim që sjell elemente të reja në proces, me qëllim respektimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve në gjykim.

54. Mbi natyrën e gjykimit në apel, Kolegji Penal në vendimin njëses 00-2024-2162(275) ka mbajtur këtë qëndrim: *“Gjykimi në shkallë të dytë, në dallim nga gjykimi në shkallë të parë, kryesisht zhvillohet mbi ato akte që janë administruar dhe i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë. Ky gjykim ka për qëllim të vlerësojë bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, prandaj si rregull ai kontrollon mënyrën se si janë vlerësuar provat dhe se si është interpretuar e zbatuar ligji në shkallë të parë. Gjykimi në apel ka një funksion kontrollues mbi vendimmarrjen e gjykatës së shkallës së parë, duke shqyrtuar pretendimet e ankuesve mbi gabimet në fakt, apo në ligj, në lidhje me vendimin e apeluar. Rregullat procedurale që ndiqen në shkallë të parë, janë të zbatueshme në apel, për aq sa ato mund të përputhen me natyrën e gjykimit në apel, objekt shqyrtimi i së cilës është vendimi i apeluar.”* Gjatë gjykimit në apel të këtyre kërkesave, në rastet kur informacioni është paraqitur me shkrim gjatë gjykimit në shkallë të parë, është diskutuar, debatuar gjatë gjykimit në atë shkallë në prezencë të palëve prokurorit dhe personit në masë sigurie e mbrojtësit të tij, krijon mundësinë që gjykata e apelit të vlerësojë shkakun e ankimit objektivisht mbi këto akte për të vlerësuar e vijuar pa vonesë nëse ka shkaqe ankimi mbi vlerësimin e nevojave të sigurimit të bëra nga gjykata e shkallës së parë.

55. Në përfundim të arsyetimit më lart, në lidhje me çështjen e shtruar për njësim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mban këtë qëndrim njëses:

Pjesëmarrja e prokurorit në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të Kodit të Procedurës Penale, gjatë shqyrtimit në seancë gjyqësore në shkallën e parë, është e detyrueshme.

Mungesa e prokurorit gjatë shqyrtimit të ankimit në apel, kur është njoftuar dhe nuk ka paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen, nuk e pengon gjykatën e apelit që të vijojë me shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar mbi verifikimin e nevojave të sigurimit dhe kërkesën për zëvendësim, apo revokim të masës së sigurimit.

IV. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

56. Për zgjidhjen e çështjes konkrete, Kolegji bazohet në qëndrimin njëses të konkluduar më lart se pjesëmarrja e prokurorit në gjykimin e verifikimit të nevojave të sigurimit, sipas nenit 246, pika 6, të KPP-së, gjatë shqyrtimit në seancë gjyqësore në shkallën e parë është e detyrueshme dhe mungesa e prokurorit gjatë shqyrtimit të ankimit në apel, kur është njoftuar dhe nuk ka paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen, nuk e pengon gjykatën e apelit që të vijojë me shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar mbi verifikimin e nevojave të sigurimit, dhe kërkesën për zëvendësim apo revokim të masës së sigurimit.

57. Referuar shkaqeve të parashtruara në rekurs, siç doli nga shqyrtimi në seancë gjyqësore e në procedurën e shqyrtimit njëses, pavarësisht se seanca në apel është zhvilluar pa pjesëmarrjen e

prokurorit, vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (objekt rekursi), bazuar në nenin 128/a, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, nuk sanksionohet me pavlefshmëri absolute. Në rrethanat e rastit konkret, Prokuroria e Posaçme mbi bazën e vendimit të gjykatës për shqyrtimin në seancë gjyqësore të kërkesës, ka paraqitur informacionin periodik me shkrim mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit, dhe ka marrë pjesë gjatë shqyrtimit në Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Gjatë shqyrtimit të ankimimit në Gjykatën e Posaçme të Apelit, prokurori është njoftuar rregullisht për seancën gjyqësore të shqyrtimit të ankimimit në apel, por pjesëmarrja në seancë nuk ka qenë e mundur për shkak të një procesi tjetër në të njëjtin orar, duke e njoftuar gjykatën për këtë pamundësi. Në këto kushte, nuk jemi para rastit kur prokuroria nuk ka paraqitur ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitjen e saj në seancën e shqyrtimit të ankimimit në apel. Prokuroria e Posaçme, nga ana e saj, nuk ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit të Posaçëm, që është dhënë pas shqyrtimit të ankimimit pa pjesëmarrjen e prokurorit, duke mos ngritur mungesën e verifikimit nga ana e Gjykatës së Apelit të Posaçëm të shkakut të mungesës së prokurorit. Rekurs ka paraqitur vetëm mbrojtja e personit në hetim, duke kontestuar zhvillimin e gjykimit në apel, pa prokuror, si njërin shkak rekursi dhe vlerësimin e nevojave të sigurimit e nevojën për vijimësinë e masës së sigurimit të bëra nga të dyja gjykatat.

58. Nga ana tjetër, rekursuesi nuk argumenton se prania e prokurorit ka qenë e domosdoshme në këtë proces, pasi pretendimet në thelb mbështeten te mungesa e arsytimit nga ana e gjykatave dhe jo në mungesë të paraqitjes së informacionit me shkrim, apo akteve të fashikullit nga ana e prokurorit. Informacioni sipas paragrafit 6 të nenit 246 të KPP-së është marrë gjatë shqyrtimit të kërkesës në shkallë të parë.

59. Ndërkohë, vlerësimi i nevojave të sigurimit është i arsyetuar nga të dyja gjykatat dhe pretendimet e parashtruara në rekurs janë të njëjtat shkaqe të parashtruar në ankim, të cilat kanë marrë përgjigje të argumentuar në vendimarrjen objekt rekursi. Nga arsyetimet e gjykatave del se prokurori ka vepruar me diligjencë të posaçme, duke reflektuar veprimtarinë si në aspektin numerik të provave të mbledhura ashtu dhe në cilësinë e tyre. Në kushtet kur nevojat e sigurimit ndaj të hetuarit Xhuljo Krasniqi mbeten të qëndrueshme dhe po ashtu nga organi i prokurorisë është treguar kujdesi i duhur që hetimet të zhvillohen me efektivitet dhe në kohën e arsyeshme, masa e arrestit ndaj tij, në të kundërt nga sa pretendohet, vijon të jetë e justifikuar ligjërisht dhe nuk cenon të drejtën e tij për liri, sepse motivohet nga një interes i lartë publik real që justifikon vazhdimin e zbatimit të saj.

60. Për sa më lart, duke qenë se pretendimet e ngritura nga mbrojtja e personit nën hetim rezultuan të pabazuara, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “e”, të KPP-së, Kolegji vlerëson se vendimarrja objekt rekursi duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 441, pika 1, shkronja “e”, dhe 438 të Kodit të Procedurës Penale;

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 235 (87-2024-345), datë 25.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Ky vendim është njësues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 27.3.2025.

Kryesues: Ilir Panda
Anëtarë: Sokol Binaj, Albana Boksi, Sandër Simoni
Anëtarë kundër: Medi Bici

MENDIM PAKICE

Unë gjyqtari në pakicë, **Medi Bici**, jam kundër vendimit njëses nr. 82, datë 27.3.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, që i përket kërkesit Xhuljo Krasniqi, me objekt: Verifikimin e nevojave aktuale të sigurimit dhe zëvendësimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, me një masë më të butë sigurimi, bazuar në nenin 246/2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), prandaj në zbatim të nenit 112/6 të KPP-së, përpiloj me shkrim mendimin tim kundër, për t’ia bashkëngjitur vendimit nr. 82, datë 27.3.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes, rezulton se:

1. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria e Posaçme) ka regjistruar procedimin penal nr. 188, të vitit 2023, në kuadër të të cilit po hetohet lidhur me kalimin e disa shtetasve të Bangladeshit nga Republika e Shqipërisë drejt kufijve të vendeve të Bashkimit Evropian nga një grup i strukturuar kriminal, i përbërë nga disa persona, veprimet e të cilëve nisin me aplikimet për t’i pajisur shtetasit e huaj në Republikën e Shqipërisë me leje unike dhe vizë “D” për punësim, me pritjen, strehimin e përkohshëm dhe transportimin e tyre deri në pikat kufitare nga ku ata kalonin ilegalisht për të mbërritur në destinacionin final.

2. Në këtë procedim, i hetuari Xhuljo Krasniqi dyshohet se në koordinim me bashkëpunëtorët e tjerë ka kryer veprimet e pritjes së shtetasve të huaj, duke plotësuar dokumentacionin për “punësimin” e tyre në aktivitetin e tij si person fizik. Në kuadër të këtij procedimi penal, me vendimin nr. 37, datë 10.4.2024, të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ndaj kërkesit është caktuar masa e sigurimit personal “arrest në burg”, si person i dyshuar për kryerjen e veprave penale “Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufijve”, e kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, të parashikuara nga nenet 298/2, 28/4, 333/a dhe 334/1 të Kodit Penal. Vendimi i masës së sigurimit personal “arrest në burg” është miratuar edhe nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

3. Më pas, kërkesi Xhuljo Krasniqi ka paraqitur kërkesë në gjykatën e shkallës së parë për verifikimin e nevojave të sigurimit dhe zëvendësimin e masës së sigurimit personal nga “arrest në burg” në një masë sigurimi më të lehtë. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (gjyqtari i hetimit paraprak) ka vendosur shqyrtimin në seancë gjyqësore të informacionit me shkrim të Prokurorisë së Posaçme, në lidhje me gjendjen e procedimit penal nr. 188, të vitit 2023, hetimet e kryera pas momentit të caktimit të masës së sigurimit personal “arrest në burg” dhe nevoja për ta mbajtur ose jo masën e sigurimit personal të “arrestit në burg”. Në gjykatën e shkallës së parë seanca është zhvilluar në prani të kërkesit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit të Prokurorisë së Posaçme. Në këtë seancë Prokuroria e Posaçme ka paraqitur informacionin me shkrim, të shoqëruar edhe me kopje të akteve të fashikullit hetimor, ndërsa në Gjykatën e Posaçme të Apelit seanca është zhvilluar pa praninë e prokurorit.

4. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. 574, datë 17.10.2024, ka vendosur:

“Rrëzimin e kërkesës së kërkesit Xhuljo Krasniqi për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, të caktuar me vendimin nr. 37, datë 10.4.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me masën sigurimit “garanci pasurore”, apo “arrest në shtëpi”, sipas neneve 236 dhe 237 të KPP-së, si të pabazuar në ligj dhe në prova”.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me vendimin nr. 235 (87-2024-345), datë 25.11.2024, ka vendosur: “... Miratimin e vendimit nr. 574, datë 17.10.2024 të

Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.” Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 82, datë 27.3.2025, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 235 (87-2024-345), datë 25.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Ky vendim është njësuës dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.”

6. Në ndryshim nga qëndrimi i shumicës, pakica është e mendimit se pjesëmarrja e prokurorit në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit është e detyrueshme, prandaj Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të pranonte rekursin e prokurorit dhe të vendoste prishjen e vendimit nr. 235 (87-2024-345), datë 25.11.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe ta dërgonte çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues në mënyrë që gjykimi të zhvillohej me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit.

7. Gjykata e apelit, ashtu si dhe gjykata e shkallës së parë është një gjykatë fakti. Kontrolli që u bën ajo vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, që vijnë me ankim përpara saj, e bëjnë atë një gjykatë ligji. Por në gjykatën e apelit, mund të lindë nevoja e debatimit të çështjes dhe provave, ose të përsëritet pjesërisht ose tërësisht shqyrtimi gjyqësor i çështjes, gjë e cila e bën gjykatën e apelit një gjykatë fakti. Në rastin në shqyrtim pjesëmarrës në gjykimin në apel ka qenë vetëm përfaqësuesi ligjor i kërkuarit Xhuljo Krasniqi dhe kjo gjykatë është mjaftuar me njoftimin e prokurorit, në një kohë që ajo ka qenë e detyruar të shtynte seancën gjyqësore dhe të siguronte pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit në gjykimin e çështjes në apel.

8. Në nenin 6 të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ) sanksionohen parimet e përgjithshme për të drejtën e një procesi të rregullt ligjor për personat që iu kufizohet liria, ndërsa garancitë parashikohen në nenin 5 të kësaj Konvente. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar, se: *“kufizimi i lirisë legjitimohet vetëm në rrugë përjashtimore dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj...”* Një nga rastet është parashikuar në pikën 1, shkronja “c”: *“...kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një veprë penale, ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryej një veprë penale ose të largohet pas kryerjes së saj.”* Gjithashtu, KEDNJ-ja parashikon disa garanci të tjera në rastin e kufizimit të lirisë së personit, duke u kontrolluar kjo situatë nga një gjykatë e pavarur, e ngritur me ligj dhe brenda afateve sa më të shkurtra. Në interpretim të këtyre dispozitave, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) është shprehur, se: *“Qëllimi kryesor i tyre është të parandalojnë privimin arbitrar ose të pajustifikuar të lirisë” (Castravet kundër Moldavisë, 2007).* Kontrolli gjyqësor që ka të bëjë me veprimet e organit të akuzës që cenon të drejtën e lirisë personale dhe përbën një element thelbësor të garancisë së parashikuar në pikën 3 të nenit 5 të KEDNJ-së. Lidhur me legjitimitetin e masës së sigurimit të caktuar më parë, veçanërisht asaj të “arrestit në burg”, normat e lartpërmendura sanksionojnë edhe detyrimin, që: *“gjykimi të caktohet, zhvillohet e përfundojë në një kohë të shpejtë e të arsyeshme, duke verifikuar nëse kërkuari (i arrestuari) është duke u mbajtur në gjendje arresti për një kohë të gjatë, jo të arsyeshme, aq më shumë nëse autoritetet nuk veprojnë në lidhje me hetimin me përgjegjshmërinë e duhur (Assenov dhe të tjerë v. Bullgarisë, 1998).*

9. Në nenin 246/6 të KPP-së është parashikuar, se: *“Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën mbi hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit. Informacioni përmban të dhëna për gjendjen e procedimit, pyetjen e të pandehurit dhe personave të tjerë, përshkrimin e të dhënave të marra dhe shoqërohet me kopje të akteve të fashikullit. Kur prokurori nuk informon në afatin e përcaktuar, gjykata verifikon nevojat e sigurimit me kërkesë të të pandehurit ose kryesisht. Gjykata, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi”.* Ligjvënësi me anë të pikës 6 të nenit 246 të KPP-së ka parashikuar, se për shkak të ndryshimit të rrethanave të çështjes, gjykata është e detyruar që ta rishikojë në mënyrë periodike situatën që ndodhet çështja dhe nëse zbutet nevoja e sigurimit gjykata mund të shfuqizojë vendimin me të cilin ka caktuar masën e sigurimit të “arrestit në burg”, duke e zëvendësuar atë me një masë siguri më të lehtë.

10. KPP-ja, me ndryshimet që ka pësuar në vitin 2017, ka parashikuar në mënyrë të shprehur parimin e dëgjimit të palëve nga gjykata nëpërmjet zhvillimit të seancës gjyqësore, pra, përpara se

gjykata të marrë një vendim në lidhje me këtë çështje. Ky detyrim, para ndryshimeve të bëra në KPP, rregullohej me anë të vendimit unifikues nr. 1, datë 8.1.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku ndër të tjera thuhet, se: *“edhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e nenit 246 të KPP-së, sikurse në rastet e tjera kur paraqitet kërkesë nga vetë i arrestuari, në interpretim e zbatim të drejtë të pikës 2 të nenit 28 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të Konventës, gjykata e shqyrton çështjen në seancë gjyqësore dhe duhet të vendosë me shpejtësi, për vijimin, revokimin, ose zëvendësimin e masës së sigurimit.”* Në këtë lloj gjykimi, gjykata shqyrton dhe vlerëson informacionin për të arrestuarin, të lidhur jo vetëm me gjendjen e procedimit në tërësi, edhe në këndvështrim të respektimit të procesit të rregullt ligjor për sa i përket ushtrimit ose jo nga ana e prokurorit të ndjekjes penale në mënyrën e duhur dhe nëse veprimet e kryera nga prokurori e justifikojnë kohëzgjatjen dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit të “arrestit në burg”. Parashikimi në nenin 246/6 të KPP-së i zbatimit në këto gjykime i rregullave të përcaktuara në nenet 248 dhe 249 të këtij Kodi ka shtuar garancitë për personin e arrestuar për një proces të rregullt ligjor, që lidhet me të drejtën për t’u njohur me aktet, me të drejtën për t’u dëgjuar dhe në veçanti me gjykimin brenda një afatit të arsyeshëm, si dhe me të drejtën e ankimit.

11. Në të tilla raste, gjykata kompetente duhet të shqyrtojë me shpejtësi çështjen në seancë gjyqësore, duke dëgjuar prokurorin dhe pretendimet përkatëse të personit ndaj të cilit është caktuar masa e sigurimit personal ose mbrojtësin e tij. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, mbështetur në parimet e normat kushtetuese dhe ndërkombëtare të detyrueshme që cituam më sipër, si dhe kriteret ligjore të parashikuara në KPP, gjykata duhet të vendosë nëse kufizimi i lirisë për të arrestuarin është ose jo e justifikuar ligjërisht. Në nenin 248 të KPP-së, parashikohen rregullat që lidhen pjesëmarrjen e palëve në gjykim (në këtë seancë gjyqësore marrin pjesë në mënyrë të detyrueshme prokurori dhe mbrojtësi i personit që i është kufizuar liria); rregullat që lidhen me të drejtën për të paraqitur prova dhe të drejtën e mbrojtjes për t’u njohur me aktet e paraqitura dhe debatin gjyqësor që zhvillohet mbi këto prova që paraqiten; si dhe me nevojën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve dhe me vlerësimin e tyre nga ana e gjykatës. Në nenin 246/6 të KPP-së është parashikuar detyrimi i gjykatës për dëgjimin e palëve (që do të thotë se edhe ky rast kërkon zhvillimin e një debati dhe zbatimin e rregullave të kontradiktoritetit), para se gjykata të vendosë mbi vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit personal.

12. Respektimi i garancive në lidhje me parimin e dëgjimit të palëve lidhet jo vetëm me të drejtën e pjesëmarrjes së mbrojtësit dhe të drejtën për t’u njohur me aktet, por edhe me të drejtën e një procesi të rregullt ligjor, garanci që parashikohen në nenin 28/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 5/4 dhe 6 të KEDNJ-së. Gjithashtu, ky parim lidhet ngushtë edhe me të drejtën e prokurorit për të ushtruar ndjekjen penale dhe për të marrë pjesë në procedimin penal. Ndjekja penale nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji, me qëllim vërtetimin e akuzës së ngritur nga prokurori. Procedimi i personit të akuzuar për kryerjen e një veprë penale nga organi i ngarkuar me këtë funksion përfshin hetimin e plotë nga organi i akuzës, mbi bazën e të cilit gjykata do të vendosë fajësinë ose pafajësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale. Elemente të këtij procesi janë: caktimi i masave të sigurimit, njoftimi i akuzës dhe pyetja e të pandehurit, këqyrja dhe kontrolli i personit ose i banesës, sekuestrime, marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe mbledhja e provave të tjera.

13. Edhe për sa i përket ligjshmërisë së caktimit dhe vijimit të zbatimit të masës së sigurimit personal dhe në veçanti arrestit në burg, kujdesi dhe përpjekjet e duhura nga ana e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale në një çështje konkrete, është një element dhe aspekt thelbësor i vlerësimit të ekzistencës ose jo të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 279 të KPP-së, prokurori ka të drejtën që të dhëna të caktuara t’i parashtrijë në informacion dhe gjykim në mënyrën e përshtatshme që nuk dëmton hetimin, duke i njoftuar gjykatës nevojën e ruajtjes së sekretit për këto veprime hetimore të caktuara. GJEDNJ-ja është shprehur, se: *“i arrestuari duhet të njihet me qëndrimet e prokurorisë dhe të ketë mundësi reale për t’u shprehur mbi to ...Të dhënat që janë thelbësore për të vlerësuar ligjshmërinë duhet t’i bëhen të njohura në çfarëdo forme të përshtatshme të arrestuarit dhe mbrojtësit të tij... Ndërkohë që mund të jetë e nevojshme për*

të mbajtur sekretin mbi disa të dhëna e prova në fazën e hetimit paraprak për të parandaluar që të dyshuarit të dëmtojnë dhënien e drejtësisë (Garcia Alva kundër Gjermanisë, 2001).

14. Përderisa ligjvënësi ka parashikuar detyrimin e gjykatës për të vendosur pasi të dëgjojë palët, e bën pjesëmarrjen e prokurorit në gjyq të detyrueshme. Gjykata detyrohet të dëgjojë prokurorin jo vetëm mbi mënyrën se si ai e ka ushtruar ndjekjen penale, në drejtim të përgjegjshmërisë që ai ka treguar në kohëzgjatjen e hetimit, të veprimeve hetimore të kryera, të saktësisë të tyre, të marrë parasysh edhe kompleksitetin dhe karakteristikat e veçanta të çështjes dhe në verifikim të pretendimeve të individit, por edhe në drejtim të qëndrimit të tij mbi rrethanat që lidhen me ekzistencën ose jo të interesit publik real, që justifikon vazhdimin e zbatimit të kësaj mase sigurimi.

15. Në nenin 128/a të KPP-së parashikohen rastet e pavlefshmërisë absolute, ku thuhet se: *“...Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me: a) kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete dhe numrin e gjyqtarëve, që janë të domosdoshëm për formimin e trupave gjykues, sipas parashikimeve të këtij Kodi; b) të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim...”* Në pikën “b” të këtij neni është parashikuar se prokurori ka të drejtë të ushtrojë ndjekjen penale si organi i vetëm i ngarkuar nga ligji dhe, gjithashtu, ai ka të drejtë të marrë pjesë në procedimin penal dhe këto dy të drejta nuk mund t’ia kufizojë askush, qoftë edhe gjykata, prandaj Gjykata e Apelit të Posaçëm nuk mund të mjaftojë vetëm me njoftimin e prokurorit, por ajo duhet të sigurojë pjesëmarrjen e tij në këtë proces penal.

16. Në nenet 11 deri 68 të KPP-së janë parashikuar subjektet që marrin pjesë në një proces penal, që janë: Gjykatat e krijuara me ligj, prokurori (neni 24 i KPP-së), policia gjyqësore, i pandehuri, mbrojtësi, viktimja, viktimja akuzuese, paditësi dhe i padituri civil. Për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor, në përputhje me parashikimet e nenit 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të KEDNJ-së është e detyrueshme pjesëmarrja e 3 subjekteve procedurale, të cilat janë: *“...gjykata e krijuar dhe formuar vetëm në bazë të ligjit, prokurori dhe mbrojtësi i të pandehurit, kur kjo është e detyrueshme ose kur i pandehuri është në mungesë.”* Pra, ligji procedural shqiptar nuk njeh asnjë rast që gjykimi mund të zhvillohet pa praninë e prokurorit, kur ndaj një personi ka filluar një procedim penal dhe deri ditën që ndaj tij mund të vendoset pushimi i çështjes penale, ose kur i dënuari përfundon dënimin dhe lirohet nga burg, ndryshe shkelet parimi i barazisë së armëve.

17. Pakica vë në dukje, se i vetmi rast kur ligji ynë procedural penal njeh gjykimin e një çështje penale, pa praninë e prokurorit në gjykatën e apelit, është rasti i nenit 427/a i KPP-së, i cili rregullon gjykimin në dhomë këshillimi, ku parashikohet, se: *“1. Në rastet kur ky Kod parashikon gjykimin në apel në dhomë këshillimi, gjykimi bëhet mbi bazë aktesh dhe/ose dokumentesh”.* Në këtë rast, ligjvënësi ka shprehur vullnetin e tij që asnjëra prej palëve të mos dëgjohet nga gjykata e apelit, përpara se ajo të marrë vendimin, i cili bazohet vetëm në aktet që ndodhen në dosje.

18. Për të gjitha këto që u thanë më sipër, pakica është e mendimit, se Kolegji Penal e ka njësuar praktikën gjyqësore dhe e ka zgjidhur çështjen në shqyrtim, jo në përputhje me ligjin procedural penal, pasi ai duhet të prishte vendimin nr. 235 (87-2024-345), datë 25.11.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe ta dërgonte çështjen për rishqyrtim po pranë kësaj gjykate, e cila duhet të zhvillonte gjykimin në prani të prokurorit.

19. Për këto shkaqe, vota ime është kundër vendimit nr. 82, datë 27.3.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Tiranë, më datë 27.3.2025.

Gjyqtar: Medi Bici